

Libri i Abstraktit

EMERGJENCA, KUJDESI INTENSIV DHE ANESTEZIONI
NË KRIZA MJEKËSORE: SFIDAT E SË ARDHMES



2025

Gold Sponsor



ProCredit Bank

1. Menaxhimi kirurgjikal i plagëve lacerokontuze në zonat me kompleksitet të lartë anatomik - Përvoja nga salla e Emergjencës.	2
2. Optimizimi i PEEP-së gjatë Ventilimit të Pacientëve me ARDS në Njësinë e Kujdesit Intensiv.....	3
3. Sfidat aktuale dhe të ardhshme në menaxhimin e emergjencave, kujdesit intensiv dhe anestezionit gjatë situatave të krizës	3
4. Kriza e padukshme në kujdesin intensiv: Epoka e rezistencës ndaj antibiotikëve	4
5. Menaxhimi i shokut septik: Integrimi i protokolleve klinike në praktikën mjekësore të përditshme.	4
6. Informacioni i gabuar online si shkaktar i krizave mjekësore emergjente: Raste të dokumentuara.....	5
7. Menaxhimi i hershëm i traumave kranio-cerebrale: Qasje klinike dhe prezantim i disa rasteve në praktikën e përditshme.	6
8. Menaxhimi i emergjencave kardiake intraoperative: Aritmitë dhe arresti kardial në sallë operative.....	6
9. Hipotireoza subklinike te pacienti me Desmoid tumor: Case report	7
10. Anestezioni spinal torakal, aplikimi i tij në Kosovë: Eksperienca 2 vjeçare.....	7
11. Anestezioni në endoskopinë digjestive: Një domosdoshmëri apo luks?.....	8
12. Lupusi Eritematoz Sistemik	8
13. Roli i CT torakale në menaxhimin e krizave respiratore akute në emergjencë dhe ICU: Një rishikim i literaturës	9
14. Sfidat e menaxhimit të arrestit kardial nga shërbimi i mjekësisë urgjente.	9
15. Menaxhimi i sindromës së lizës tumorale si emergjencë hematologjike: Rast klinik dhe rishikim literature.....	10
16. Si do të menaxhohet dukuria e narkomanisë: Sfidat në të ardhmen.	10
17. Prediktorët e vdekshmërisë nga format e rënda të COVID-19.....	12
18. Lodhja profesionale (Burnout) dhe stresi kronik tek mjekët e Emergjencës: Mekanizmat, pasojat dhe strategjitë ndërhyrëse .	13
19. Zbulimi dhe trajtimi i hershëm i sepsës në praktikën ambulatorë	13
20. Arresti kardial intraoperativ - Përvoja e anesteziologëve në Kosovë	14
21. 5% kanë ngecje të lehtë të fëmijëve.....	14
22. Menaxhimi i infarktit akut të miokardit	14
23. Simulimi klinik si mjet trajnimi dhe sigurie në anesteziologji.....	15
24. Trajtimi i dehidratimeve të rënda dhe çrregullimeve elektrolitike në emergjenca: Një përmbledhje klinike mbi qasjet bashkëkohore dhe sfidat e zbatimit	16
25. Vlerësimi i shkallës së dhembjes me VAS (Visual Analog Scale) te pacientët pas histerektomisë.....	16
26. Pllakat aterosklerotike dhe stroku akut: Sfidat për emergjencën, kujdesin intenziv dhe trajtimin modern	17
27. Telemedicina në kujdesin intensiv.....	17
28. Parandalimi dhe menaxhimi i hipotensionit te anestezioni spinal	18
29. Sfidat e rezistencës ndaj antimikrobikëve në mjedisin e kujdesit intensiv.....	18
30. Edemi alergjik e laringut: Menaxhimi dhe sfidat klinike.....	19
31. Arresti kardial: Rëndësia e kohës së ndërhyrjes dhe faktorëve prognostik në ambient spitalor dhe jashtëspitalor	19
32. Zbatimi i Diagnostikës së Shpejtë Molekulare për të Luftuar Organizmat Rezistentë ndaj Shumë Barnave në Njësitë e Kujdesit Intensiv.....	20
33. Diagnostika laboratorike e infeksionit me Hantan Virus në Kosovë	21
34. Roli imunomodulues i vaksinimit kundër SARS-CoV2 në reduktimin e inflamacionit te pacientët e infektuar	21
35. Kujdesi ndaj traumave në fatkeqësi dhe katastrofa	22
36. Emergjenca mjekësore te infeksioni me hantavirus	23
37. Rëndësia e analizave laboratorike në menaxhimin e pacientëve në kujdesin intensiv	24
38. Inteligjenca artificiale në diagnostikimin imazherik të embolisë pulmonare - Një rishikim	25
39. Prezantim rasti - Pacienti me politraumë të rëndë dhe hemopneumotoraks.....	26
40. Vlerësimi i efektit të kombinuar të Citomegalovirusit kongjenital dhe virusit Epstein-Barr në zhvillimin e autizmit.....	26
41. Ketofoli në sedacionin procedural në urgjencë: Optimizimi i sigurisë, stabilitetit hemodinamik dhe rikuperimit në rastet urgjente	27
42. Sepsa meningokoksike si sëmundje emergjente në Kosovë	28
43. Emergjenca mjekësore te sëmundjet infektive	28
44. Rishikimi i paradigmes së sepsës: Udhëzuesi S3 dhe sfida e zbatimit klinik.....	29
45. Burnout në kujdesin intensiv: Dimensioni njerëzor i kujdesit shëndetësor.....	30

46. Komplikimet dhe menaxhimi i anestezisë për liposuksionin me vëllim të madh.....	30
47. Rast i rrallë i ulçerës akute hemorragjike të rektumit.....	31
48. Ventilimi mbrojtës i mushkërive në ARDS.....	31
49. Monitorimi invaziv i ICP-së: I kotë apo i denjë?.....	33
50. Anestezia jo-opioide.....	34
51. Sepsa - Vrasësi i heshtur.....	35
52. Rëndësia e urgjencës: ndikimi i vonesës së ndërhyrjes kirurgjike në mortalitetin e shkaktuar nga frakturat proksimale të femurit tek pacientët geriatrikë	35
53. Diseksioni akut i harkut të aortës - sfidat e menaxhimit anesteziologjik dhe mbrojtja cerebrale	36
54. Bakteret MDR: Kërcënimi i ri në njësitë e kujdesit intensiv	37
55. Hemoperfuzioni dhe teknikat dializuese adsorbuese si terapi ndihmëse në mjedisin e njësisë së kujdesit intensiv (ICU)	38
56. Aplikimi Perioperativ i Kundrapulsatorit Intraaortik (IABP)	40
57. Rabdomioliza dhe dëmtimi akut i veshkave: Njohja e hershme dhe menaxhimi në kontekstin perioperativ dhe në njësitë e kujdesit intensiv (ICU)	41
58. Roli i Infuzionit të Aminoacideve në Parandalimin e Dëmtimit Akut të Veshkave tek Pacientët me Ndërhyrje Kirurgjike Kardiake.....	41
59. Përditësim mbi trajtimin dhe menaxhimin e shokut kardiogjen.....	42

1. Menaxhimi kirurgjikal i plagëve lacerokontuze në zonat me kompleksitet të lartë anatomik - Përvoja nga salla e Emergjencës

Andi Elshani ¹ Dafina Basholli ² Vjollca Haklaj ²

¹ Department of General medicine, Faculty of Medicine, University of Prishtina, Prishtina, Kosovo.

² Specialist of Emergency Medicine, Faculty of Medicine, University of Prishtina, Prishtina, Kosovo.

Abstrakti:

Hyrje: Plagët lacerokontuze në zona me kompleksitet të lartë anatomik, si dora dhe fytyra, paraqesin sfidë të madhe kirurgjikale për shkak të afërsisë së strukturave neurovaskulare e tendinoze. Trajtimi i vonuar mund të shkaktojë pasoja funksionale dhe estetike.

Qëllimi: Të paraqitet përvoja klinike dhe qasja kirurgjikale në menaxhimin e këtyre plagëve, duke theksuar rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe koordinimit multidisiplinor.

Metodologjia: Janë analizuar rastet e trajtuara në sallën e emergjencës sipas protokollit ATLS. U krye vlerësimi neurovaskular, irigacion dhe eksplorim kirurgjikal në rastet me hemorragji të pandalshme, dëmtime tendinoze ose nervore.

Rezultatet: Eksplorimi i hershëm kirurgjikal brenda 6-12 orëve ruajti funksionin dhe uli komplikimet. Riparimi i nervave dhe tendinave brenda 5-7 dite dha rezultate të mira funksionale. Komplikimet më të shpeshta ishin infeksionet lokale dhe ngurtësimi articular, të reduktuara me antibiotikë profilaktik dhe fizioterapi të hershme.

Përfundim: Një qasje e bazuar në protokolle të standardizuara, njohuri anatomike dhe bashkëpunim multidisiplinor siguron rezultate të mira funksionale dhe estetike. Kujdesi postoperativ i vazhdueshëm mbetet kyç për rikuperim të plotë.

2. Optimizimi i PEEP-së gjatë Ventilimit të Pacientëve me ARDS në Njësinë e Kujdesit Intensiv

Blerim Arapi, MD

Shef i Departamentit të Anestezisë dhe Njësisë së Kujdesit Intensiv, Spitali Hygeia, Tiranë

Abstrakti:

Hyrje: Sindroma e Distresit Akut Respirator (ARDS) është një kontribues i madh në shkallën e lartë të vdekshmërisë dhe ndërlikimeve të pacientët e Njësisë së Kujdesit Intensiv. Strategjitë mbrojtëse të ventilimit mekanik, duke përfshirë optimizimin e PEEP-së dhe vëllimet e ulëta të baticës, rekomandohen në menaxhimin e ARDS-së.

Materialet dhe Metodat: Ky prezantim përfshin një studim retrospektiv të 50 pacientëve me ARDS të rëndë ($\text{PaO}_2/\text{FiO}_2 \leq 100$ mmHg), të ndarë në dy grupe me nga 25 pacientë. Raporti M/F ishte 1:1; pacientët ishin ASA I-II, me një moshë mesatare prej 55 ± 15 vjeç, $V_t = 6$ ml/kg, dhe shkallë të lartë të frymëmarrjes. Grupi 1 mori PEEP të lartë fikse (≥ 12 cm H_2O), ndërsa Grupi 2 mori PEEP të individualizuar dhe të optimizuar. Rezultatet e analizuara përfshinin vdekshmërinë, kohëzgjatjen mesatare të intubimit, kohëzgjatjen e qëndrimit në kujdesin intensiv në kujdesin intensiv dhe incidencën e barotraumës.

Rezultatet: Në Grupin 1 (PEEP jo i titruar), vdekshmëria ishte 56% (14 pacientë), qëndrimi në kujdesin intensiv ishte 48 ditë, kohëzgjatja mesatare e intubimit ishte 35 ditë dhe barotrauma ndodhi në 52% të rasteve (13 pacientë). Në Grupin 2 (PEEP i optimizuar), vdekshmëria ishte 44% (11 pacientë), qëndrimi mesatar në kujdesin intensiv ishte 38 ditë, kohëzgjatja mesatare e intubimit ishte 27 ditë dhe barotrauma ndodhi në 32% të rasteve (8 pacientë).

Përfundimet: Optimizimi i PEEP-së gjatë ventilimit mekanik tek pacientët me ARDS shoqërohet me ulje të vdekshmërisë, qëndrime më të shkurtra në kujdesin intensiv dhe kohëzgjatje më të shkurta të intubimit, dhe më pak ndërlikime të tilla si barotrauma.

Fjalë kyçe: PEEP optimale, ARDS, vdekshmëri, pneumotoraks, intubim

3. Sfidat aktuale dhe të ardhshme në menaxhimin e emergjencave, kujdesit intensiv dhe anestezionit gjatë situatave të krizës

Dafina Luzha - Doktoreshë në praktikë profesionale

Jehonë Luzha Beqiraj - Doktoreshë e Mjekësisë

Abstrakti:

Hyrje: Shpeshherë të metat e sistemit shëndetësor në sektorin e menaxhimit të emergjencave, kujdesit intensiv dhe anestezionit, bëhen më të dukshme gjatë situatave të krizës, qoftë në rast pandemish, fatkeqësish natyrore apo luftërash. Hartimi i strategjive dhe procedurave standarde për veprim në situata të tilla, bazuar në nevojat specifike të sistemeve shëndetësore është një domosdoshmëri.

Qëllimi i punimit: Ky punim synon që përmes rishikimit të literaturës, të eksplorojë sfidat e tanishme dhe të ardhshme që shfaqen gjatë situatave të krizës në menaxhimin e emergjencave, kujdesit intensiv dhe anestezionit.

Metodologjia: Punimi është realizuar përmes metodës së rishikimit të literaturës ekzistuese në databazat kryesore shkencore si PubMed, ResearchGate, Google Scholar dhe Scopus.

Rezultatet: Hulumtimet tregojnë se sfidat që shfaqen gjatë situatave të krizës përfshijnë: mungesën e kuadrove shëndetësore, kapacitetin e pamjaftueshëm spitalor, mungesën e pajisjeve shëndetësore njëpërdorimëshe, mungesën e barnave, mungesën e strategjive paraprake për rastet e krizës, koordinimin dhe komunikimin jo të mirë ndërmjet kuadrove shëndetësore, menaxhimin jo adekuat të mbetjeve biomjekësore, si dhe mbingarkesën emocionale dhe rraskapitjen fizike të stafit mjekësor, të cilat theksohen veçanërisht në raste krize.

Konkluzioni: Nga analiza e literaturës, arritëm në përfundim se sfidat në situata krizash, qofshin ato pandemi, fatkeqësi natyrore apo luftëra, shpesh janë të pashmangshme pavarësisht nga parapërgatitjet. Megjithatë, analizimi i incidenteve paraprake (si rasti i COVID-19) dhe përmirësimi i pikave të dobëta në sistemin shëndetësor, si dhe investimi në politika që mbështesin në mënyrë të vazhdueshme avancimin mjekësor, luajnë rol kritik në tejkalimin e këtyre sfidave.

4. Kriza e padukshme në kujdesin intensiv: Epoka e rezistencës ndaj antibiotikëve

Dr. Drenica Nika

Doktoreshë e Mjekësisë

Abstrakti:

Rezistenca ndaj antibiotikëve është shndërruar në një nga kërcënimet kryesore të shëndetit publik dhe një sfidë e përditshme në kujdesin intensiv. Pacientët kritikë, të cilët shpesh kërkojnë terapi invazive dhe trajtim me antibiotikë të spektrit të gjerë, janë veçanërisht të rrezikuar nga infeksionet multirezistente. Shembuj tipik përfshijnë pneumoninë e lidhur me ventilatorin, sepsën refraktare, infeksionet postoperative të plagëve kirurgjikale, bakterieminë e lidhur me kateterët qendrorë dhe infeksionet e traktit urinar. Patogjenët më të shpeshtë përfshijnë Methicillin-Resistant Staphylococcus aureus, Klebsiella pneumoniae, Acinetobacter baumannii dhe Pseudomonas aeruginosa, që shpesh zhvillohen në heshtje, por me pasoja fatale, duke e vendosur rezistencën ndaj antibiotikëve si një krizë të padukshme brenda kujdesit intensiv. Ky rishikim bazohet në literaturën shkencore të dekadës së fundit mbi kujdesin ndaj pacientëve kritik dhe synon të nxjerrë në pah rëndësinë e kësaj krize dhe strategjitë e ardhshme të menaxhimit. Kjo emergjencë ndikon në kujdesin intensiv, sillën e operacionit dhe periudhën post-operative, duke e vështirësuar ndjeshëm rikuperimin e pacientëve. Përballë kësaj sfide, e ardhmja kërkon zgjidhje inovative, përfshirë programe të fuqizuara të antibiotik stewardship (menaxhimit racional të përdorimit të antibiotikëve), aplikimin e diagnostikës molekulare në kohë reale dhe eksplorimin e terapive alternative, si përdorimi i bakteriofagëve apo imunoterapia. Rezistenca ndaj antibiotikëve nuk përfaqëson thjesht një fenomen mikrobiologjik, por një krizë mjekësore që kërcënon bazat e kujdesit emergjent, intensiv dhe perioperativ. Përballja me këtë epokë të re kërkon ndërgjegjësim të gjerë, bashkëpunim multidisiplinor dhe strategji afatgjata, për të garantuar sigurinë dhe mbijetesën e pacientëve kritik.

5. Menaxhimi i shokut septik: Integrimi i protokolleve klinike në praktikën mjekësore të përditshme.

Dr. Elda Lota

Abstrakti:

Hyrje: Shoku septik definohet si një gjendje kërcënuese për jetën, e karakterizuar nga disfunksioni i organeve si rezultat i një përgjigjeje të çrregulluar të organizmit ndaj infeksionit. Klinikisht, manifestohet me hipotension refraktar, konfuzion, oliguri, lëkurë të ftohtë dhe cianotike. Diagnoza bazohet në kriteret *Sepsis-3* dhe parametrat laboratorik. Menaxhimi modern i shokut septik konsiston në fluidoterapi, përdorimin e vazopresorëve, kontrollin e burimit të infeksionit dhe monitorimin e parametrave hemodinamik.

Metodologjia: Ky punim paraqet një rishikim të literaturës, duke analizuar të dhëna nga bazat *PubMed* dhe *Scopus* gjatë viteve të fundit. Janë përfshirë studime klinike dhe udhëzime ndërkombëtare mbi menaxhimin e shokut septik.

Rezultatet: Studimet e fundit theksojnë rëndësinë e zëvendësimit të vëllimit intravaskular me fluide, duke përdorur kristaloide të balancuara dhe monitorim dinamik për të shmangur mbingarkesën me fluide. Norepinefrina është linja e parë vasopresore, ndërsa shtimi i vazopresinës rekomandohet në shok refraktar. Laktatemia përdoret si tregues prognostik si dhe tregon efikasitetin e trajtimit. Udhëzimet e “Surviving Sepsis Campaign” vazhdojnë të jenë standardi kryesor në praktikën klinike.

Diskutimi: Evidencat tregojnë se ndërhyrja e hershme dhe aplikimi strikt i protokolleve reduktojnë mortalitetin dhe komplikimet. Megjithatë, sfidat kryesore mbeten zbatimi i barabartë i këtyre protokolleve në mjedise me burime të kufizuara dhe personalizimi i trajtimit sipas profilit të pacientit.

Përfundimi: Menaxhimi modern i shokut septik kërkon qasje multidisiplinore, të mbështetur në protokolle të standardizuara dhe monitorim dinamik. Implementimi i hershëm dhe korrekt i këtyre qasjeve përmirëson ndjeshëm prognozën dhe ul shkallën e vdekshmërisë.

Fjalë kyçe: Shoku septik, menaxhimi, protokollet klinike vazopresorët, fluidet.

6. Informacioni i gabuar online si shkaktar i krizave mjekësore emergjente: Raste të dokumentuara

Dr. Erëza Durmishi¹

¹Studente PhD në Mjekësi Klinike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë

Abstrakti:

Hyrje/Qëllimi: Periudha në të cilën po jetojmë karakterizohet nga një qasje masive dhe e menjëhershme në burime të informacionit online, shpesh pa verifikim shkencor. Dezinformimi mjekësor në internet tashmë është një dukuri mjaft e shpeshtë. Pacientët duke tentuar të vetë-mjekohen bazuar në informacionet që kanë parë dhe dëgjuar në internet, jo rrallë marrin vendime të gabuara shëndetësore të cilat mund të sjellin komplikime emergjente. Ky punim paraqet raste konkrete ku ndjekja e këshillave nga informacionet online, çoi në gjendje kritike që kërkuan kujdes intensiv.

Materialet dhe Metodot: Janë analizuar katër raste të dokumentuara nga literatura mjekësore e indeksuar në Scopus (2, 4, 5) dhe nga mediat ndërkombëtare të besueshme (1, 3), ku pacientët kishin ndjekur trajtime të pambështetura me prova shkencore. Të dhënat përfshijnë përshkrimin e gjendjes klinike, ndërhyrjet mjekësore dhe rezultatet.

Rezultatet: Fatkeqësisht, pacientët u paraqitën në faza të avancuara të sëmundjes ose me toksicitet akut. Tre nga katër pacientët përfunduan fatalisht pavarësisht kujdesit intensiv maksimal. Vetë-mjekimi me substanca toksike shkaktoi arrest kardiak, insuficiencë respiratore dhe komplikime metabolike të pakthyeshme, kurse rastet me refuzim të vaksinës dhe trajtime standarde për COVID-19 çuan në insuficiencë respiratore terminale dhe vdekje.

Përfundimi: Informacioni i gabuar online paraqet një sfidë kritike për të ardhmen e sistemit shëndetësor. Jo rrallë mund të çojë në gjendje që kërkojnë kujdes intensiv dhe përfundime fatale. Edukimi shëndetësor, komunikimi efektiv midis mjekëve dhe pacientëve, si dhe kontrolli rigoroz i burimeve të informacionit janë strategji thelbësore për parandalimin e këtyre situatave. Mjekët duhet të veprojnë proaktivisht si filtra të informacionit, duke shmangur praktikën e vetë-mjekimit me informacione të pabazuara.

Fjalë kyçe: Emergjenca, kujdes intensiv, dezinformimi mjekësor, mortalitet, trajtimet alternative.

7. Menaxhimi i hershëm i traumave kranio-cerebrale: Qasje klinike dhe prezantim i disa rasteve në praktikën e përditshme.

Dr. Fatlirë Gashi-Hoxha

Mjeke e Përgjithshme

Abstrakti:

Hyrje: Traumat kranio-cerebrale (TCC) janë ndër shkaqet më të zakonshme të paraqitjes në shërbimet emergjente dhe përfaqësojnë një sfidë të vazhdueshme për mjekët e vijës së parë. Ato mund të variojnë nga goditje të lehta deri te dëmtime të rënda që kërcënojnë jetën, dhe ndikojnë në pacientët të të gjitha moshave. Vlerësimi dhe menaxhimi i hershëm janë thelbësorë për të parandaluar komplikime afatgjate neurologjike dhe për të udhëhequr trajtimin adekuat.

Qëllimi i punimit: Ky punim synon të prezantojë një përmbledhje të qasjes klinike në traumat kranio-cerebrale tek pacientët e moshave të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e vlerësimit të hershëm dhe të strukturës së vendimmarrjes mjekësore. Përmes analizës së disa rasteve klinike, synohet të ilustruhet rëndësia e triazhimit, përdorimit të algoritmeve klinike dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor në menaxhimin e TCC.

Metodologjia: Punimi përfshin një shqyrtim të literaturës bashkëkohore mbi traumat kranio-cerebrale, si dhe analizën e disa rasteve klinike të trajtuara në praktikën e përditshme, përfshirë pacientët fëmijë dhe të rritur. Rastet janë shqyrtuar në kontekstin e simptomave të paraqitura, shkallës së dëmtimit, qasjes diagnostike dhe vendimeve për trajtim ose referim.

Rezultatet: Rastet klinike theksojnë rëndësinë e vlerësimit sistematik të pacientëve me trauma në kokë dhe aftësinë e mjekut të vijës së parë për të dalluar situatat me rrezik të lartë. Në disa raste, menaxhimi i hershëm në bazë të protokolleve standard e ka parandaluar përqendrimin neurologjik dhe ka mundur trajtim në kohë. U vu re gjithashtu dallimi në prezantimin klinik dhe reagimin ndaj traumës midis grup-moshave të ndryshme.

Përfundimi: Menaxhimi i hershëm i traumave kranio-cerebrale kërkon njohuri të mirë klinike, vigjilencë dhe aftësi për të marrë vendime të shpejta. Mjeku i Përgjithshëm ka një rol kyç në këtë proces, duke qenë shpesh kontakti i parë me pacientin. Një qasje e strukturuar dhe e bazuar në evidencë është thelbësore për rritjen e sigurisë së pacientit dhe përmirësimin e rezultateve klinike.

8. Menaxhimi i emergjencave kardiake intraoperative: Aritmitë dhe arresti kardial në sallë operative

Dr. Festa Xhepa

Abstrakti:

Hyrje: Emergjenat kardiake intraoperative, si aritmitë malinje dhe arresti kardial, janë ngjarje të rralla por me mortalitet të lartë. Pavarësisht përparimeve në monitorim, ato mbeten sfiduese për ekipin e anestezionit. Ky punim shqyrton faktorët predispozues, udhëzimet klinike dhe qasjet e trajtimit sipas literaturës më të fundit.

Metodologjia: Është kryer një rishikim i literaturës ndërkombëtare (PubMed, Cochrane, EMBASE), duke përfshirë udhëzimet ndërkombëtare si dhe studimet klinike (meta-analiza, rishikime sistematike) të publikuara në vitet 2020-2025.

Rezultatet: Incidenca e arrestit kardial intraoperativ raportohet 2-6 raste në 10,000 anestezi. Mortaliteti mbetet i lartë, por rreth gjysma e pacientëve mbijetojnë deri në daljen nga spitali kur ndërhyrja është e menjëhershme. Faktorët kryesorë predispozues janë mosha e shtyrë, statusi ASA i lartë dhe ndërhyrjet emergjente. Aritmitë më të zakonshme përfshijnë bradikarditë vagale dhe takikarditë ventrikulare, që trajtohen me atropinë, amiodaron ose defibrilim. Udhëzimet theksojnë domosdoshmërinë e identifikimit dhe korrigjimit të shkaqeve të kthyeshme si hipovolemia, hipoksia, embolia ose tamponada.

Diskutim: Trajnimet simulative, algoritmet e dedikuara perioperative dhe bashkërendimi multidisiplinor përmirësojnë ndjeshëm rezultatet. Sfidat kryesore mbetet harmonizimi i udhëzimeve ndërkombëtare me praktikën e përditshme klinike.

Përfundim: Menaxhimi efektiv i këtyre emergjencave kardiake kërkon zbatim rigoroz të protokolleve dhe bashkëpunim ekipor për të rritur mbijetesën dhe për të siguruar rezultat neurologjik të favorshëm.

Fjalë kyçe: Arrest kardiak intraoperativ; aritmi; anesteziologji; kujdes intensiv; resuscitim kardiopulmonar; udhëzime klinike.

9. Hipotireoza subklinike te pacienti me Desmoid tumor: Case report

Dr. Genc Shala, Internist - Endokrinolog (PhDc)

Abstrakti:

Një paciente femër në trajtim me Pazopanib (inhibitor i tirozin-kinazës) për tumor desmoid, i është paraqitur hipotiroidizmi subklinik.

Tumoret desmoidë janë tumore të rralla, me invasion lokal, jo-malinje të indeve të buta. Ata nuk metastazojnë, por mund të jenë shumë agresiv, duke shkaktuar shkatërrim të madh lokal, dhimbje dhe dëmtim funksional për shkak të rritjes së tyre infiltrative dhe tendencës për t'u rikthyer pas heqjes kirurgjikale. Trajtimet kryesore janë: kirurgjia, inhibitorët e tirozin-kinazës (pazopanib), kimioterapia, inhibitorët e gama sekretazës.

Hipotiroidizmi, përfshirë atë subklinik, është një efekt anësor i njohur dhe i zakonshëm i pazopanibit, ndërkohë që mekanizmat e saktë nuk janë plotësisht të qartë.

Monitorimi i rregullt i funksionit të tiroides është i detyrueshëm për pacientët që marrin pazopanib. Hipotiroidizmi ose hipotiroidizmi subklinik i shkaktuar nga pazopanibi ndonjëherë mund të jetë i kthyeshëm pas ndërprerjes së ilaçit, por në disa raste, mund të jetë i përhershëm, duke kërkuar terapi të vazhdueshme.

10. Anestezioni spinal torakal, aplikimi i tij në Kosovë: Eksperienca 2 vjeçare

Dr. Leon Hajdari¹, Prof. Asst. Fatos Sada^{1,3}, Asst. Dr. Egzon Daku^{1,2}, Besë Morina¹

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

² Qendra Klinike Universitare e Kosovës

³ Spitali Kavaja

Abstrakti:

Hyrje: Anestezioni spinal torakal segmental (TSSA) është një teknikë e avancuar neuroaksiale që konsiston në administrimin e anestetikut lokal në hapësirën subarahnoidale të shtyllës kurrizore të pjesës torakale, zakonisht në segmentet T4-T10. Përdoret si alternativë ndaj anestezisë së përgjithshme, veçanërisht te pacientët me risk të lartë.

Qëllimi: Të analizohet përdorimi i TSSA te pacientët që iu nënshtruan ndërhyrjeve kirurgjikale në Klinikën e Kirurgjisë Torakale në QKUK dhe në Spitalin Kavaja gjatë viteve 2022-2024, me fokus në karakteristikat demografike, ASA klasifikimin, sëmundjet bashkëshoqëruese, llojin e ndërhyrjes dhe nivelin e aplikimit.

Metodologjia: Ky është një hulumtim shkencor retrospektiv, i realizuar nëpërmjet analizës së të dhënave mjekësore të marra nga Klinika e Kirurgjisë Torakale në QKUK dhe nga Spitali Kavaja, të pacientëve që iu nënshtruan procedurës së TSSA gjatë periudhës 2022-2024.

Rezultatet: Nga 11 pacientë, 91% ishin femra. 63.63% ishin mbi 70 vjeç dhe 27.27% në moshën 61-70 vjeç. Procedurat më të shpeshta ishin mastektomia (54.5%), ndërsa të tjerat përfshinin biopsinë ekscizionale të gjirit, riparim të aneurizmës së aortës abdominale,olecistektomi, rezekcion të zorrës dhe rekonstrukcion të kolostomës (secila nga një rast). HTA ishte komorbiditeti më i shpeshtë (54.5%), pasuar nga DMT2, COPD dhe IHD (27.3%). Teknika më e përdorur ishte në nivelin T5-T6 (7 nga 11 raste), por u përdorën edhe nivelet T6-T7, T7-T8 dhe T10-T11.

Konkluzionet: TSSA rezultoi të jetë një teknikë efektive dhe e sigurt për ndërhyrje të ndryshme kirurgjikale, veçanërisht te pacientët geriatrikë dhe me komorbiditete. Mungesa e komplikimeve të raportuara përforcon vlerën e saj si alternativë ndaj anestezisë së përgjithshme, veçanërisht në rastet kur aplikohet nga profesionistët me përvojë.

Fjalët kyçe: Anestezioni regjion, TSSA, QKUK, Spitali Kavaja, anestezioni gjeneralizuar, ASA klasifikimi, komorbiditet, pacientët geriatrikë.

11. Anestezioni në endoskopinë digjестive: Një domosdoshmëri apo luks?

Dr. Leutrim Shabani

Klinika e Gastroenterologjisë, QKUK.

Abstrakti:

Endoskopia gastrointestinale, thelbësore për diagnozën dhe trajtimin e sëmundjeve, shpesh shkakton dhimbje dhe ankth. Sedacioni, duke përfshirë sedacionin minimal/moderat (p.sh., midazolam, fentanil), sedacionin e thellë (p.sh., propofol) dhe anestezinë e përgjithshme, përdoret gjerësisht për të rritur komfortin e pacientit.

Ky rishikim sistematik analizon rolin e sedacionit/anestezisë në endoskopinë digjестive, duke adresuar pyetjen nëse është një domosdoshmëri apo luks.

Studimet tregojnë përfitime të qarta: sedacioni rrit ndjeshëm kënaqësinë e pacientit dhe gatishmërinë për ri-procedura. Ai përmirëson cilësinë teknike të procedurës, duke rritur shkallën e zbulimit të adenomave (ADR) dhe polipeve (PDR), si dhe shkallën e intubimit cecal/ileal dhe përfundimit të endoskopisë së sipërme digjестive. Kjo kontribuon në depistim më efikas të kancerit.

Megjithatë, sedacioni shoqërohet me rreziqe, kryesisht komplikacione kardiopulmonare si hipotensioni dhe depresioni respirator, megjithëse shkalla e tyre është përgjithësisht e ulët (<2.5%) me monitorim adekuat. Ai gjithashtu rrit kostot direkte dhe zgjat kohën e rimëkëmbjes. Analizat e kostos-përfitimit sugjerojnë se kostot shtesë mund të justifikohen nga përfitimet në cilësi dhe efikasitet afatgjatë.

Përfundimisht, ndërsa endoskopia pa sedacion është e realizueshme për pacientët e përzgjedhur, sedacioni në endoskopinë digjестive shfaqet si një domosdoshmëri për shumicën e rasteve. Ai siguron rezultate optimale procedurale dhe një përvojë të përmirësuar të pacientit, duke balancuar sigurinë me efikasitetin klinik. Vendimi duhet të individualizohet bazuar në gjendjen e pacientit dhe kompleksitetin e procedurës.

Fjalët kyçe: Anestezioni, sedimi, endoskopia digjестive.

12. Lupusi Eritematoz Sistemik

Dr. Nazmiye Martinaj

Abstrakti:

Një pacient mashkull 27 vjeç paraqitet në urgjencë me dhimbje të fortë retrosternale, shoqëruar me djersitje të ftohta, dhe nauze. EKG tregoi ngritje të segmentit ST në derivacionet anteriore, ndërsa troponina ishte e rritur. U vendos diagnoza e infarktut akut të miokardit dhe u krye koronarografi urgjente me vendosje të një stendi në arterien e bllokuar. Gjatë qëndrimit spitalor, u vunë re lëzime të lëkurës fotosensitive, artralgji, dhe proteinuri. Analizat imunologjike treguan ANA në titër të lartë and anti-dsDNA pozitiv, duke konfirmuar diagnozën e LES. Pacienti u trajtua me terapi imunosupresive dhe antiplateletare.

Fjalët kyçe: lupusi eritematoz sistemik, infarkt miokardi, pacient i ri, stent koronare, rrezik kardiovaskular.

13. Roli i CT torakale në menaxhimin e krizave respiratore akute në emergjencë dhe ICU: Një rishikim i literaturës

Ass. Dr. Pranvera Harshova Hoxhaj
Specialiste e Radiologjisë

Abstrakti:

Hyrye: Krizat respiratore akute përfaqësojnë një nga emergjencat më të shpeshta dhe më kërcënuese për jetën në praktikën spitalore, si në shërbimet e urgjencës, ashtu edhe në kujdesin intensiv. Tomografia kompjuterike torakale (CT) ka fituar një rol të pazëvendësueshëm në diagnostikimin dhe menaxhimin e këtyre gjendjeve, duke ofruar informacion të shpejtë, të detajuar dhe të besueshëm mbi patologjitë si embolia pulmonare (EP), sindroma e distresit respirator akut (ARDS), pneumonitë e rënda, si dhe komplikimet post-COVID-19. Ky rishikim synon të analizojë kontributin e CT torakale në vendimmarrjen klinike dhe në përmirësimin e trajtimit multidisiplinor të pacientëve me insuficiencë respiratore akute.

Metodologjia: U krye një rishikim narrativ i literaturës përmes bazave të të dhënave **PubMed** dhe **Scopus**, duke përfshirë artikuj të publikuar midis viteve 2015-2024. Janë shqyrtuar studime klinike prospektive dhe retrospektive, rishikime sistematike, metaanaliza dhe udhëzime ndërkombëtare. U përdorën fjalë kyçe të synuara si “*CT chest*”, “*acute respiratory failure*”, “*pulmonary embolism*”, “*ARDS*” dhe “*intensive care*”.

Rezultatet: CT torakale është metoda më e besueshme për konfirmimin e EP përmes angio-CT, duke ndikuar drejtpërdrejt në fillimin e terapisë antikoaguluese. Po ashtu, ajo lejon karakterizimin e infiltreteve të ARDS dhe diferencimin nga edemi kardiogjen ose pneumonitë infektive, çka ndihmon në përcaktimin e trajtimit të duhur. Gjithashtu, CT është e domosdoshme në diagnostikimin e pneumotoraksit, efuzioneve pleurale dhe komplikimeve të ventilimit mekanik. Përtej rolit diagnostik, ajo ndikon në vendime kritike për intubim, ventilim të asistuar ose menaxhim invaziv.

Përfundime: CT torakale është tashmë një komponent kyç i menaxhimit modern të krizave respiratore akute. Disponueshmëria e saj 24/7 në qendrat spitalore dhe rritja e bashkëpunimit ndërdisiplinor ndërmjet radiologëve, pneumologëve, intensivistëve dhe kardiologëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e mbijetesës dhe rezultateve klinike të pacientëve.

Fjalë kyçe: CT torakale, insuficiencë respiratore, emboli pulmonare, ARDS, emergjencë, ICU, rishikim literature.

14. Sfidat e menaxhimit të arrestit kardial nga shërbimi i mjekësisë urgjente.

Dr. Rinor Maliqi¹

¹QKMF - Junik

Abstrakti:

Arresti kardial jashtë spitalor përfaqëson një nga urgjencat më kritike dhe jetëkërcënuese në mjekësinë emergjente, me mortalitet të lartë pavarësisht përparimeve të fundit terapeutike. Shkalla e mbijetesës varet ngushtë nga diagnostikimi i hershëm, fillimi i menjëhershëm i reanimimit kardiopulmonar (CPR), vendosja e linjës venoze, administrimi në kohë i medikamenteve, si dhe përdorimi në kohë i defibrilatorit.

Në praktikë, sfidat kryesore përfshijnë vonesën në aktivizimin e sistemit të urgjencës, mungesën e njohurive bazike të popullatës për realizimin e reanimimit kardiopulmonar, kufizimet e institucionit shëndetësor në kuptim të pajisjeve të nevojshme si dhe gjatë transportit drejt spitalit. Për më tepër, heterogjeniteti i trajnimit të ekipeve mjekësore dhe mungesa e protokolleve të standardizuara shpesh ndikojnë negativisht në rezultatet e resusitimit.

Përmirësimi i kujdesit pre-hospitalor kërkon ndërhyrje të shumanshme: edukimin e komunitetit për njohjen e shenjave të hershme të arrestit kardial dhe për realizimin e reanimimit kardiopulmonar nga të pranishmit, vendosjen e defibrilatorëve automatik të jashtëm (AED) në hapësira publike dhe trajnimin periodik të ekipeve të urgjencës për zbatimin e protokolleve ndërkombëtare të

avancuara të reanimimit kardiopulmonar. Monitorimi në kohë reale gjatë transportit përbën një potencial shtesë për rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve.

Arrestet kardiak jashtë spitalor mbetet një sfidë madhore për shëndetin publik, por përmes edukimit, pajisjes adekuate dhe protokolleve të standardizuara, është e mundur të përmirësohen ndjeshëm rezultatet e mbijetesës dhe cilësia e jetës së pacientëve pas reanimimit kardiopulmonar.

15. Menaxhimi i sindromës së lizës tumorale si emergjencë hematologjike: Rast klinik dhe rishikim literature

Dr. Shqiponjë Morina¹, ko-autorët: Dr. Idriz Trolli¹, Dr. Miranda Hoti¹

¹ QKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Klinika e Hematologjisë.

Abstrakti:

Hyrje: Sindroma e lizës tumorale (TLS) është një emergjencë hemato-onkologjike që rezulton nga lirimi masiv i përmbajtjes intracelulare të qelizave tumorale pas shkatërrimit rapid të tyre nga kimioterapia.

Qëllimi: i punimit është të analizohet efektiviteti i barnave që përdoren për menaxhimin e hiperurikemisë në TLS.

Metodologjia: Ky punim paraqet një rishikim literature të mbështetur në studime të publikuara në data bazat kryesore shkencore, si dhe një rast klinik ilustrues.

Pacienti N.N. 42-vjeçar me limfomë difuze B-qelizore masive intra-abdominale, zhvilloi TLS pas ciklit të parë të R-CHOP në klinikë. Brenda 24 orësh, ai shfaqti nauze, të vjella, konfuzion, oliguri dhe hipotension. Analizat laboratorike evidentuan hiperkalemi (6.7 mmol/L), hiperurikemi (980 µmol/L), hipokalcemi (1.65 mmol/L), hiperfosfatemi (2.6 mmol/L), rritje të LDH (1600 u/L), kreatinina 265 µmol/L, urea 17mmol/l. U administrua hidratim IV me NaCl 0.9% (3L/m²/ditë), febeksostat 80 mg/ditë, trajtim emergjent i hiperkalemisë, antiemetikë, steroide dhe oksigjenoterapi, por për shkak të përkeqësimit renal u fillua hemodializa. Pas tre seancave hemodializë, parametrat u normalizuan dhe u mundësua vazhdimi i kimioterapisë.

Rezultatet: Për menaxhimin e hiperurikemisë përdoren kryesisht rasburikaza, allopurinoli dhe febeksostati. Rasburikaza, vetëm ose e kombinuar me allopurinol, ul acidin urik më shpejt se opsionet e tjera, por kostot dhe siguria kufizojnë përdorimin e saj. Febeksostati rezultoi më efektiv se allopurinoli në këtë grup pacientësh, ndërsa allopurinoli mbetet alternativë e zakonshme për rastet me rrezik më të ulët.

Përfundim: Menaxhimi i hershëm i TLS me monitorim, terapi mbështetëse dhe agjentë urikozurikë është thelbësor për uljen e mortalitetit dhe vazhdimin e trajtimit onkologjik.

16. Si do të menaxhohet dukuria e narkomanisë: Sfida në të ardhmen.

Prof. Dr sci. Sylen Vranica, Neuropsikiatër

Mrs. Shqipe Sekiraga, Psikologe Klinike

Abstrakti:

Hyrje: Dukuria e narkomanisë është prezente pothuajse në të gjithë botën edhe në trevat tona ajo është prezente në formë të kultivimit, shpërndarjes dhe konsumimit. Kur dihen të dhënat se dilerët dhe narkomanët renditen ndër më brutalët dhe agresivët në rruzullin tokësor, ndaj mund të merret me mend i gjithë serioziteti dhe komblusiteti i kësaj dukurie.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë shkaqet, pasojat dhe strategjitë e parandalimit të narkomanisë, duke u fokusuar në ndikimin e saj psikologjik, social dhe shëndetësor tek individët dhe komuniteti. Punimi synon të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e politikave efektive për luftimin e këtij fenomeni.

Materialet dhe Metodatat: Gjatë një periudhe disa vjeçare në ambulancën tonë Refleksi dhe IHC janë intervistuar 100 persona (95% meshkuj, 5% femra) të mjeteve narkotike, të moshave dhe profesioneve të ndryshme. Është përdorur anamneza, të dhënat heteroanamnestike, vëzhgimi fizik, ekzaminimi neurologjik dhe eksplorimi psikiatriko-psikologjik. Gjatë intervistës, në mesin e shumë faktorëve nxitës për konsumimin e mjeteve narkotike, më së shumti janë përmendur:

- Kureshtja
- Mendimi i gabuar se me konsumimin e mjeteve narkotike mund të tejkalohet monotonja ekzistuese
- Njohuria e mangët për pasojat negative të mjeteve narkotike nga ana e fillestarëve dhe familjarëve të tyre
- Shoqërimi i fillestarëve me narkomanë shumëvjeçarë
- Tendencat e të rinjve për imitim të figurave mediatiqe, artistike, sportive etj.
- Indiferenca dhe neglizhenca e rrethit të ngushtë e të gjerë, si edhe e shoqërisë në përgjithësi ndaj konsumuesve të mjeteve narkotike, duke i lënë në mëshirën e fatit dhe në kthetrat e narkomanisë, të cilët mendojnë se do të gjejnë "përkrahje dhe mbështetje nga kjo dukuri"

Rezultatet dhe diskutimi: Në sferën e narkomanisë qarkullojnë mjete materiale dukshëm më të larta se në sferën mjekësore dhe të tjera. Kur dihet se e dhëna se akterët e kësaj dukurie mund të kenë përfitime materiale enorme për një kohë të shkurtër, atëherë nënkuptohet hezitimi dhe refuzimi i tyre për të hequr dorë nga kjo dukuri. Do t'i paraqesim disa mangësi dhe lëshime në menaxhimin e deritanishëm të kësaj dukurie, siç janë:

- Vetëkënaqësia e personelit mjekësor duke paraqitur të dhëna statistikore të narkomanëve të lajmëruar dhe duke paraqitur disa raste të varësisë nga mjetet narkotike, pa aplikuar psikoterapi individuale dhe grupe për trajtim përfundimtar.
- Menaxhimi i kësaj dukurie nga ana e personave jo profesionist, jo kompetent, insuficient dhe pa përgatitje paraprake për këtë menaxhim, vetëm sa për të bërë "emër" dhe për përfitime materiale jo të merituar.
- Lajmet nga mediat e ndryshme shpeshherë janë në formë bombastike, tendencioze dhe skandaloze, vetëm për të bërë lajme, duke mos dhënë këshilla të mëtejshme për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e konsumuesve të mjeteve narkotike.
- Mungesa e kontrollit të brendshëm të dilerëve dhe narkodilerëve rreth enteve shëndetësore ku janë duke u trajtuar konsumuesit e mjeteve narkotike.
- Mungesa e kontrollit nga ana e pjesëtarëve të sigurimit të personave të botës narkomane nëpër koncerte, tubime, manifestime dhe të tjera.
- Mosmbajtja apo mbajtja e rrallë e ligjëratave për këtë dukuri nëpër shkolla, xhami, kisha dhe tubime të tjera për pasojat negative të kësaj dukurie.

Rekomandimet: Të intensifikohet edukimi shëndetësor në shkolla dhe institucione për rrezikun e narkomanisë.

- Të organizohen fushata sensibilizuese për ndërgjegjësimin e familjeve dhe komunitetit.
- Të përfordhet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shëndetësore, arsimore dhe organeve të rendit.
- Të trajnohen profesionistët për ofrimin e psikoterapisë individuale dhe grupe për të varurit.
- Të kontrollohet qasja e dilerëve në ambientet publike dhe institucionet shëndetësore.
- Të mbështeten programet për rehabilitim dhe ri-integrim social të ish-konsumuesve.
- Të rritet roli i mediave në informimin objektiv dhe edukues për pasojat e narkomanisë.
- Të zhvillohen politikat sociale që adresojnë shkaqet themelore të varësisë, si papunësia dhe mungesa e mbështetjes emocionale.

Përfundimi: Dukuria e narkomanisë në trevat tona paraqet ndër sfidat më serioze dhe komplekse, që do të duhej të praktikohen mënyra të reja më të pranishme. Është koha e fundit që të formohet një ent i përshtatshëm me ekspertë të mirëfilltë dhe kulminant të kësaj dukurie, në mënyrë që t'ju ndihmohet sa më shumë konsumuesve të mjeteve narkotike.

Nëse hezitohet apo refuzohet ky propozim, atëherë do të vazhdojë situata e tanishme jo e përshtatshme, duke rrezikuar jetën e të rinjve tanë.

17. Prediktorët e vdekshmërisë nga format e rënda të COVID-19

Aliu-Bejta A^{1a}, Ajazaj-Berisha L¹, Namani S^a, Berisha A¹, Kasumi A¹, Geca N¹, Krasniqi V¹, Rexha V¹, Mehmeti M¹, Hasani L¹, Imeri Z, Bejta P, Pllana-Hajdari D³, Zogu B, Maliqi A, Shatri P, Berisha F¹, Idrizaj E¹, Shala Q¹, Matoshi A¹.

¹ Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Infektive

² Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Radiologjisë

³ Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Departamenti i Mikrobiologjisë

^a Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë

Abstrakti:

Hyrje: Insuficienca respiratorike është manifestimi më markant i formës së rëndë të COVID-19. Një varg faktorësh u identifikuan si prediktorë të zhvillimit të formës së rëndë të COVID-19.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi ishte evaluimi i parametrave klinik e laboratorik dhe lidhshmëria e tyre me vdekshmërinë nga COVID-19.

Metodologjia: Analizë retrospektive e të dhënave klinike e laboratorike të pacientëve me forma të rënda të COVID-19 të spitalizuar në Klinikën Infektive, Prishtinë. Në hulumtim u përfshinë 1188 pacientë të konfirmuar pozitiv në SARS-CoV-2 me PCR në strisho nazofaringeale. Përbushja e cilitdo nga kriteret në vazhdim ishte kusht për përfshirje në hulumtim: a) $FR \geq 30$ respiracione/min, b) $SO_2 \leq 93\%$, c) $pO_2/FiO_2 \leq 300$ mmHg, d) insuficiencë respiratorike/ventilim mekanik, e) shok, f) disfunkcion organik/trajtim në kujdesin intenziv. Analiza e regresionit logjistik u përdor për evaluimin e lidhshmërisë së vdekshmërisë me parametrat klinik e laboratorik. Testet u konsideruan statistikisht signifikante nëse $p < 0.05$.

Rezultatet: Nga numri total i pacientëve, 744 ishin meshkuj. Vdekja u regjistrua në 33% të rasteve. Mosha mesatare e pacientëve ishte 64.9 ± 12.3 vjeç. Nevoja për ventilim mekanik u paraqit në 27% të rasteve. Në njësitë e kujdesit intenziv u trajtuan 256 pacient. Sëmundjet shoqëruese u regjistruan në 76.1% të rasteve. Faktorë të ndërlidhur me rrjedhë të pafavorshme të sëmundjes u identifikuan: mosha, ventilimi mekanik, insuficienca kronike renale, SPOK, $CRP > 200$ mg/dl.

Konkluzionet: Mosha e shtyrë, sëmundjet kronike renale dhe respiratorike, ventilimi mekanik dhe $CRP > 200$ mg/dl ishin faktorë rreziku për rrjedhë të pafavorshme të sëmundjes.

Fjalët kyçe: Forma e rëndë e COVID-19, faktorë rreziku, vdekshmëria.

18. Llodhja profesionale (Burnout) dhe stresi kronik tek mjekët e Emergjencës: Mekanizmat, pasojat dhe strategjitë ndërhyrëse

Dr. Albana Ahmeti

Abstrakti:

Hyrje: Sindroma e lodhjes profesionale (burnout) është një gjendje e shkaktuar nga stresi i tepërt në vendin e punës dhe shpesh karakterizohet nga dimensionet e lodhjes emocionale, depersonalizimit dhe arritjeve të reduktuara personale (1, 2). Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon sindromën e lodhjes profesionale si “një sindromë që rezulton nga stresi kronik në punë që nuk është menaxhuar në mënyrë efektive” (3). Tek profesionistët shëndetësorë, veçanërisht në mjekësinë emergjente, sindroma e lodhjes profesionale mund të ndikojë në cilësi të ulët të kujdesit ndaj pacientëve (4), rezultate të pafavorshme klinike, mungesa në punë dhe ulje të produktivitetit (5).

Metodologjia: Artikulli përbën një rishikim të literaturës, i cili mbështetet në informacione shkencore nga burime të ndryshme si PubMed, Medscape.

Rezultatet: Specialitetet mjekësore që ndodhen në vijën e parë të kujdesit si mjekësia emergjente dhe kujdesi intensiv, përballen me rrezikun më të lartë të zhvillimit të “burnout” (6). Studimet sugjerojnë se mungesa e gjumit, orët e gjata të punës, turnet e natës dhe natyra stresuese e punës janë ndër shkaqet kryesore të lodhjes profesionale, ankthit dhe depresionit tek profesionistët shëndetësorë (7).

Diskutimi dhe konkluzionet: Spektri heterogjen dhe i paparashikueshëm i pacientëve në shërbimet e urgjencës, që përfshin pacientë me sëmundje kritike, ngjarje akute apo sjellje agresive e bën mjekësinë emergjente një fushë dinamike, por jashtëzakonisht sfiduese. Sipas hulumtimeve të bëra, raportohet një shkallë e lodhjes profesionale (burnout) prej 78% tek infermierët e emergjencës dhe 70% tek mjekët e emergjencës, shifra që i tejkalojnë ato të profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor (8).

19. Zbulimi dhe trajtimi i hershëm i sepsës në praktikën ambulatorë

Dr. Arbër Avdiu, Dr. Agnesa Koxha

Abstrakti:

Qëllimi: Sepsa është një nga sfidat më të mëdha në mjekësinë moderne, veçanërisht në ambientin ambulator ku mungojnë mjetet diagnostike të avancuara. Ky punim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi njohjen dhe trajtimin e hershëm të sepsës në praktikën e mjekut familjar, duke theksuar rëndësinë e veprimit të menjëhershëm dhe zbulimit të hershëm.

Metodologjia: Është realizuar një rishikim i literaturës relevante nga vitet 2010-2024, përfshirë udhëzimet ndërkombëtare si: “Surviving Sepsis Campaign” dhe përkufizimin Sepsis-3. Janë shqyrtuar mjetet diagnostike në dispozicion të mjekut të kujdesit parësor (si qSOFA dhe CRP), strategjitë empirike të trajtimit dhe rëndësia e ndjekjes dinamike të pacientëve.

Rezultatet: Pavarësisht prezantimit jo specifik klinik, sepsa mund të zbulohet herët përmes vlerësimit të statusit mendor, shenjave vitale dhe përdorimit të skemave të thjeshta si qSOFA. Ndërhyrjet e hershme si fillimi i antibiotikëve dhe administrimi i lëngjeve IV në ambulantë, para dërgimit në spital, mund të ulin ndjeshëm mortalitetin.

Përfundimi: Roli i mjekut familjar është vendimtar në thyerjen e zinxhirit të avancimit të sepsës. Zbatimi i protokolleve të thjeshta, edukimi i pacientëve dhe bashkëpunimi ndërprofesional janë çelës për përmirësimin e mbijetesës së pacientëve me sepsë.

20. Arresti kardiak intraoperativ - Përvoja e anesteziologëve në Kosovë

Bardhë Agaj*, Antigona Hasani

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë

Abstrakti:

Arrest i kardiak intraoperativ është një situatë kritike që ndodh gjatë ndërhyrjeve kirurgjike nën anestezion dhe kërkon reagim të menjëhershëm, koordinim efikas dhe njohuri të avancuara për trajtim nga ana e ekipit mjekësor.

Ky studim shqyrton përvojat dhe qëndrimet e profesionistëve të anesteziologjisë në Kosovë në lidhje me menaxhimin e rasteve të arrestit kardiak intraoperativ. Përmes një pyetësi elektronik me 30 pjesëmarrës (specialist, subspecialist dhe specialist), u grumbulluan të dhënat mbi përvojën e tyre klinike, përdorimin e protokolleve standarde të reanimimit si dhe perceptimin e tyre lidhur me nevojën për trajnime të vazhdueshme.

Rezultatet treguan se 97% e pjesëmarrësve kishin hasur të paktën një rast arresti kardiak intraoperativ gjatë karrierës së tyre. Megjithatë, vetëm 57% kishin ndjekur trajnime të avancuara për reanimim gjatë dy viteve të fundit, dhe 30% nuk ishin të sigurt nëse protokollet për trajtim ishin të standardizuara në institucionin ku punonin. Shumica e rasteve ndodhën gjatë fazës intraoperative, duke konfirmuar të dhënat nga literatura, që evidentojnë këtë periudhë si më kritike.

Për më tepër, pjesa më e madhe e të anketuarve e konsideruan thelbësore përditësimin periodik të njohurive për CPR dhe ALS. Ky studim thekson domosdoshmërinë për edukim të vazhdueshëm, aplikimin e simulimeve praktike dhe vendosjen e protokolleve të qarta institucionale për të përmirësuar gatishmërinë dhe sigurinë klinike gjatë situatave të arrestit kardiak intraoperativ.

21. 5% kanë ngecje të lehtë të fëmijëve

20% probleme organike pediatrike

10% probleme kirurgjike dhe fiziatrike pediatrike

Konkluzionet dhe impaktet: Autizmi është një paadtësi zhvillimore e përhershme. Karakteristikat e aftësisë së kufizuar; zhvillimi i pakët ose mungesa e të folurit, shmangia e kontaktit social ose ndërgjegjësimi dhe rutinat e sjelljeve nuk përjetohen në të njëjtën shkallë për të gjithë ata që jetojnë me autizëm.

Si ndikon autizmi në jetë?

Njerëzit autikë mund të veprojnë në një mënyrë të ndryshme nga njerëzit e tjerë, e kanë të vështirë të kuptojnë se si mendojnë ose ndihen njerëzit e tjerë. Gjeni gjëra të tilla si: dritat e ndezura ose zhurmat e forta dërmuese, stresues ose të pakëndshme, shqetësoheni ose mërzhiteni për situata të panjohura dhe ngjarje shoqërore. Duhet më shumë kohë për të kuptuar informacionin.

Fjalë kyçe: Autizmi, izolimi, incidenca, parandalimi, trajtimi

22. Menaxhimi i infarktit akut të miokardit

Dr. Blend Kryeziu

Abstrakti:

Hyrja: Infarkti akut i miokardit (IAM) mbetet një ndër shkaqet kryesore të vdekshmërisë kardiovaskulare në mbarë botën, veçanërisht në popullata me faktorë të shumtë risku dhe qasje të kufizuar në kujdesin emergjent. Diagnoza dhe trajtimi i hershëm janë jetikë për mbijetesën dhe për reduktimin e dëmtimeve të përhershme të muskullit të zemrës.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë qasjet më bashkëkohore në diagnostikim dhe trajtim të IAM, me synim përmirësimin e prognozës dhe reduktimin e komplikimeve, dhe të identifikojë sfidat në praktikën e përditshme mjekësore.

Metodologjia: Ky punim është bazuar në shqyrtimin e literaturës shkencore ndërkombëtare, udhëzimeve klinike të Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC) dhe të Shoqatës Amerikane të Zemrës (AHA), dhe studime të botuara në 10 vitet e fundit në databaza si PubMed. Janë shqyrtuar protokollat e diagnostikimit, strategjitë reperfuzive (PCI dhe terapi trombolitike), menaxhimi farmakologjik, si dhe analiza e protokolleve të menaxhimit emergjent.

Përfundimi: Menaxhimi i suksesshëm i IAM kërkon një qasje multidisiplinore, zbatimin e hershëm dhe korrekt të protokolleve të trajtimit ndikon ndjeshëm në uljen e vdekshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Megjithatë, pengesa si vonesa në paraqitje, mungesa e burimeve dhe trajnimi i pamjaftueshëm vazhdojnë të jenë sfida të pranishme.

Zbatimi i protokolleve të standardizuara dhe përditësimi i praktikës klinike janë thelbësore për adresimin e sfidave.

Fjalë kyçe: Infarkti akut i miokardit, menaxhim emergjent, PCI, terapi trombolitike.

23. Simulimi klinik si mjet trajnimi dhe sigurie në anestezilogji

Bleonë Hajdari¹, Erzana Maliqi¹, Verona Hyseni²

¹Doktoreshë e mjekësisë ²Doktoreshë e stomatologjisë.

Abstrakti:

Hyrje: Anestezilogjia është një specialitet praktik që kërkon zotërimin e aftësive teknike dhe jo-teknike përmes ushtrimit të përsëritur. Simulimi është futur si një metodë moderne mësimore, me synim të përmirësimit të sigurisë së pacientit dhe trajnimit klinik.

Qëllimi: Ky punim synon të shqyrtojë efektivitetin e trajnimit të bazuar në simulim në anestezilogji dhe ndikimin e tij në performancën e specializantëve.

Metodologjia: Është kryer analizë e literaturës së fundit, duke përfshirë studime që trajtojnë simulimin e integruar, qasjen e klasës së përmbytur dhe menaxhimin e situatave kritike si embolia pulmonare perioperative dhe pneumotoraksi tensiv.

Rezultatet: Evidencat tregojnë se simulimi përmirëson aftësitë teknike dhe jo-teknike, rrit ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor, si dhe forcon vetëbesimin e specializantëve në menaxhimin e emergjencave. Pjesëmarrësit raportuan përmirësim në marrjen e vendimeve dhe aplikimin e ndërhyrjeve të shpejta si: menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes dhe dekompresioni në pneumotoraks tensiv. Studimet treguan gjithashtu nota më të larta, veçanërisht në punën ekipore, komunikim dhe menaxhim të detyrave. Qasjet si klasa e përmbytur rezultuan në përgatitje më efektive dhe performancë më të lartë në teste teorike e praktike, pa rritur ngarkesën e përgjithshme të të mësuarit. Simulimi ndërdisiplinor përmirësoi komunikimin mes specialiteteve dhe rriti efikasitetin e reagimit në situata kritike.

Përfundimi: Simulimi në anestezilogji përfaqëson një strategji të domosdoshme edukative, që plotëson mësimdhënien tradicionale dhe kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e sigurisë së pacientit. Integrimi i tij në kurrikulën e specializimeve mjekësore është i nevojshëm për të përgatitur profesionistë më të aftë dhe më të sigurt.

pah rëndësinë e menaxhimit holistik të të sëmurëve me DMT2 të sapo diagnostikuar, pra përpos kontrollit të glikemisë të bëhet edhe parandalimi i hershëm i komplikimeve vaskulare.

Fjalët kyçe: diabeti melit i sapo diagnostikuar, CT calcium score, komplikimet e diabetit melit.

24. Trajtimi i dehidratimeve të rënda dhe çrregullimeve elektrolitike në emergjenca: Një përmbledhje klinike mbi qasjet bashkëkohore dhe sfidat e zbatimit

Dr. Dorentina Ukmata

Abstrakti:

Hyrje: Dehidratimi i rëndë dhe çrregullimet elektrolitike janë emergjenca të shpeshta dhe kërcënuese për jetën. Shkaktohen kryesisht nga diarre akute, të vjella, mungesë e lëngjeve, djersitje apo djegie. Menaxhimi i tyre kërkon vlerësim të shpejtë dhe zëvendësim të kontrolluar të lëngjeve dhe elektroliteve për të shmangur komplikime si edemi cerebrale, aritmi apo dështim organik.

Metodologjia: Për këtë punim janë shqyrtuar publikime shkencore (2017-2024) nga data baza si: PubMed dhe Scopus, që trajtojnë protokollat e rehidratimit dhe menaxhimit të çrregullimeve elektrolitike.

Rezultatet: Rezultatet treguan se Plani C i OBSH-së për fëmijët dhe zgjidhjet izotonike (Ringer Laktat, 0.9% NaCl) për të rriturit janë më efektive në trajtimin e dehidratimit të rëndë. Shtimi i elektroliteve si KCl dhe glukozë është thelbësor për rivendosjen metabolike. Në hipernatremi kërkohet ulje e kontrolluar e natriumit për të shmangur edemin cerebrale. Gjithashtu ORS mbetet qasje fillestare e rekomanduar në rastet stabile.

Diskutimi: Zbatimi i trajtimeve varet nga përgatitja e stafit, burimet në dispozicion dhe ndjekja e protokolleve. Në mjediset me burime të kufizuara, mungesa e monitorimit elektrolitik dhe e zgjidhjeve të duhura e vështirëson menaxhimin. Nevojitet edukim i vazhdueshëm për të dalluar format e dehidratimit dhe për të përmirësuar reagimin klinik.

Përfundimi: Trajtimi i dehidratimit të rëndë dhe çrregullimeve elektrolitike kërkon vlerësim të shpejtë dhe ndërhyrje të kontrolluar. Evidenca mbështet qasje të kombinuara me rehidratim gradual, korrigjim elektrolitik dhe monitorim të kujdesshëm. Përshtatja e protokolleve dhe përmirësimi i qasjes në laborator janë thelbësore për reduktimin e komplikimeve.

Fjalë kyçe: Dehidratimi, çrregullime elektrolitike, hipernatremi, emergjencë mjekësore, terapia intravenoze

25. Vlerësimi i shkallës së dhembjes me VAS (Visual Analog Scale) te pacientët pas histerektomisë

Dr. Eda Ramaxhiku, Dr. Rajmonda Nallbani

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

Abstrakti:

Hyrje: Dhembja postoperative përbën një sfidë të rëndësishme në kujdesin perioperativ, pasi menaxhimi joefektiv i saj mund të ndikojë negativisht në rikuperimin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së pacientit. Ky studim synon të vlerësojë intensitetin e dhembjes përmes Shkallës Vizuale Analoge (VAS) pas histerektomisë dhe të analizojë efektivitetin e trajtimit analgetik.

Metodologjia: Studimi është i tipit retrospektiv dhe është realizuar në kujdesin intensiv të Klinikës Obstetrike Gjinekologjike në QKUK. Janë përfshirë 24 paciente që iu nënshtruan histerektomisë dhe plotësuan kriteret e përfshirjes.

Rezultatet: Në këtë hulumtim vërejmë se anestezioni gjeneral u përdor më shpesh. Vlerat mesatare të VAS treguan ulje graduale të dhembjes postoperative në dy grupet. Niveli më i ulët i dhembjes u regjistrua pas 6 orësh në qetësi tek pacientet me anestezion gjeneral (VAS = 2.31), ndërsa grupi me anestezion spinal shfaqti vlera më të ulëta menjëherë pas operacionit (VAS = 2.0).

Menaxhimi i dhembjes u realizua përmes kombinimeve të ndryshme analgetike, duke siguruar kontroll efektiv. Studimi thekson ndikimin e llojit të anestezionit në intensitetin e dhembjes dhe rëndësinë e qasjes së strukturuar në menaxhimin postoperativ.

Përfundimi: Vlerësimi i dhembjes me VAS dhe përdorimi i strategjive multimodale analgetike përmirësojnë kontrollin e saj. Rezultatet theksojnë nevojën për protokolle standarde dhe monitorim aktiv për të optimizuar rikuperimin dhe cilësinë e jetës së pacienteve.

Fjalët kyçe: Dhembja postoperative, VAS, histerektomia, menaxhimi, anestezioni spinal, anestezioni gjeneral, analgetikët.

26. Pllakat aterosklerotike dhe stroku akut: Sfidat për emergjencën, kujdesin intensiv dhe trajtimin modern

Endrit Muji¹, Erisa Selmani², Muharrem Sadiku³

¹ Doktor i Mjekësisë, ² Studente e Fakultetit të Mjekësisë, ³ Specialist i Radiologjisë.

Abstrakti:

Hyrje: Pllakat aterosklerotike të arterieve karotide përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të rasteve të insultit iskemik akut. Përtej shkallës së stenoze të lumenit, karakteristikat e ndjeshmërisë së pllakës - hemorragjia intrapllakare (IPH), bërthama lipidike-nekrotike (LRNC), kapsula fibrotike e hollë apo e çarë, ulcerimi dhe neovaskularizimi - njihen gjithnjë e më shumë si parashikues të fortë të ngjarjeve embolike.

Qëllimi i punimit: Të përmbledhen studimet më të fundit mbi (1) patofiziologjinë e pllakës karotide, (2) rolin e teknikave të imazherisë si echoduplexi i karotideve, CT/CTA dhe MRI/MRA në identifikimin e saj, dhe (3) ndikimin që këto gjetje kanë në diagnozën emergjente, menaxhimin akut si dhe atij intensiv.

Materiali dhe metodologjia: Është bërë rishikim i meta-analizave, rishikimeve sistematike të publikuara në bazat e të dhënave si: PubMed, Cochrane, ResearchGate dhe Scopus, si dhe udhërrëfyesve klinik me korrelacion imazheri-patologji.

Rezultatet: MRI me rezolucion të lartë zbulon praninë e hemorragjisë intrapllakare, e cila lidhet me një rrezik më të madh për incidentet cerebrovaskulare në krahasim me pllakat pa këto karakteristika. Ultrazëri me kontrast ndihmon në zbulimin e neovaskularizimit dhe ulceracionit sipërfaqësor, duke përmirësuar stratifikimin e rrezikut. CTA ofron një mjet të shpejtë dhe lehtë të qasshëm për vlerësimin e morfologjisë së pllakës, ndërsa nuk duhet harruar DSA që paraqet standard të artë të vlerësimit të stenozeve dhe që tani kryhet vetëm në rastet e intervenimit endovaskular. Integrimi i këtyre metodave dhe gjetjeve ndihmon në triazhim, në përcaktimin e kohës së ndërhyrjes karotide dhe në kujdesin intensiv, megjithëse mungojnë ende protokolle të standardizuara dhe prova të forta.

Përfundime: Imazheria multimodale e kombinuar me vendimmarrje multidisciplinore optimizon trajtimin e individualizuar, ndërsa kërkimet e ardhshme duhet të testojnë strategjitë e bazuara në karakteristikat e pllakës.

27. Telemedicina në kujdesin intensiv

Dr. Erblin Jashari, Dr. Haki Jashari

Abstrakti:

Hyrje: Telemedicina ka fituar një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në kujdesin intensiv, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për pacientët kritik dhe duke adresuar sfidat e tilla si mungesa e stafit dhe qasja e kufizuar në ekspertizë të specializuar. Përdorimi i tele-ICU shërben jo vetëm për të përmirësuar cilësinë e trajtimit, por edhe për të rritur sigurinë e pacientëve dhe për të optimizuar proceset klinike në kushte të ndryshme spitalore.

Qëllimi i punimit: Synimi është të analizohet roli i ndërhyrjeve të tele-ICU në zgjerimin e mbulimit të kujdesit intensiv, rritjen e përputhshmërisë me praktikën më të mirë klinike dhe menaxhimin e transferimit të pacientëve. Gjithashtu, punimi synon të vlerësojë efektivitetin e këtyre ndërhyrjeve në rezultatet klinike.

Materiali dhe metodologjia: Për përgatitjen e kësaj teme janë shfrytëzuar punimet shkencore të botuara në revista shkencore dhe të pranishme në PubMed. Punimet e përdorura shkencore janë burim i të dhënave reprezentative dhe punime të kohëve të fundit.

Përfundimi: Ndërhyrjet me tele-ICU kanë treguar përfitime të qarta në zgjerimin e mbulimit të kujdesit intensiv në komunitete me mungesë të ekspertizës, si dhe në përmirësimin e përputhshmërisë me standardet klinike në spitalet terciare. Megjithatë, efektiviteti i tyre varet nga konteksti i implementimit dhe nga bashkëpunimi ndërmjet ekipeve në distancë dhe atyre pranë shtratit të pacientit. Pavarësisht sfidave në kosto dhe ndryshimet organizative, tele-ICU paraqitet si një mundësi premtuese për përmirësimin e rezultateve klinike dhe rritjen e sigurisë së pacientëve.

Fjalët kyçe: Telemedicina, kujdesi intensiv.

28. Parandalimi dhe menaxhimi i hipotensionit të anestezioni spinal

Dr. Erblinë Morina, Dr. Rajmonda Nallbani-Komoni

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

Abstrakti:

Hyrje - Efekt i zakonshëm fiziologjik i bllokadës spinale është vazodilatacioni dhe ulja e rezistencës vaskulare, duke çuar në hipotension. Prandaj, parandalimi dhe menaxhimi i tij mbeten ndër sfidat kryesore të anestezioni spinal.

Metodologjia - Ky hulumtim i tipit retrospektiv u realizua në repartin e Kujdesit Intensiv të Klinikës Obstetrike Gjinekologjike në QKUK. Nga 61 paciente fillestare, me aplikimin e kriterëve të përjashtimit (pacientet me hipertension kronik ose sëmundje hipertensive të shtatzënisë) u analizuan të dhënat e 50 pacientëve.

Rezultatet - Nga ky hulumtim vërejmë se kemi rënie të tensionit arterial në periudhën intraoperative por rikthim gradual në periudhën postoperative. Hipotensioni gjatë periudhës intraoperative shfaqet te 66% e pacientëve, me rënie mesatare të tensionit arterial prej 16% krahasuar me vlerën bazale. Menaxhimi përmes tretjeve kristaloide (1.5-2L) dhe administrimi i efedrinës me dozë mesatare 30mg, sipas rezultateve mund të themi se ka qenë menaxhim efektiv për të ruajtur stabilitetin hemodinamik.

Përfundimi - Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se me zbatimin e masave të rekomanduara parandaluese dhe menaxhuese sipas udhëzimeve bashkëkohore ndërkombëtare, stabiliteti hemodinamik i pacientëve mund të mbahet në nivel të kënaqshëm. Gjithashtu, shumica e pacientëve kanë raportuar nivel të lartë kënaqshmërie gjatë procedurës.

Fjalët kyçe: anestezioni spinal, hipotensioni, parandalimi, menaxhimi, periudha preoperative, intraoperative, postoperative.

29. Sfidat e rezistencës ndaj antimikrobikëve në mjedisin e kujdesit intensiv

Dr. Erza Jashari, Dr. Haki Jashari

Abstrakti:

Hyrje: Rezistenca ndaj antimikrobikëve është një kërcënim serioz global, veçanërisht në njësitë e kujdesit intensiv, ku pacientët shpesh i nënshtrohen procedurave invazive dhe përdorin pajisje mjekësore që rrisin rrezikun e infeksioneve. Kombinimi i gjendjes së dobësuar imunitare të pacientëve dhe përdorimit të shpeshtë të antibiotikëve me spektër të gjerë krijon terren të favorshëm për zhvillimin e mikroorganizmave multirezistentë. Ky punim shqyrton shkaqet, pasojat dhe qasjet për kontrollin e këtij problemi në praktikën klinike.

Qëllimi i punimit: Synimi është të analizohet roli i faktorëve kryesor në shfaqjen dhe përhapjen e rezistencës ndaj antimikrobikëve në njësitë e kujdesit intensiv dhe të vlerësohen strategjitë më efektive për parandalim dhe menaxhim.

Materiali dhe metodologjia: Për përgatitjen e kësaj teme janë shfrytëzuar punimet shkencore të botuara në revista shkencore dhe të pranishme në PubMed. Punimet e përdorura shkencore janë burim i të dhënave reprezentative dhe punime të kohëve të fundit.

Përfundimi: Rezistenca antimikrobike përbën një problem të ndërlikuar që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e trajtimit dhe rrit nivelin e mortalitetit në pacientët e shtruar. Faktorët kryesor janë përdorimi i pakontrolluar i antibiotikëve, mungesa e qasjeve të standardizuara dhe transmetimi ndërmjet pacientëve. Zbatimi i strategjive të bazuara në menaxhimin racional të antibiotikëve, mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe forcimin e masave të kontrollit të infeksioneve paraqitet si rruga më premtuese për uljen e barrës së këtij problemi dhe përmirësimin e rezultateve klinike.

Fjalët kyçe: Rezistenca antimikrobike, kujdesi intensiv.

30. Edemi alergjike e laringut: Menaxhimi dhe sfidat klinike

Dr. Fat Huma

Abstrakti:

Hyrje: Edemi alergjike e laringut përfaqëson një nga emergjencat më kritike në praktikën klinike, duke rrezikuar obstrukcion të menjëhershëm të rrugëve të frymëmarrjes. Pa ndërhyrje, vdekshmëria arrin deri në 30-50%, ndërsa me trajtim të hershëm zbret në nivele minimale. Qëllimi i këtij punimi është të përmbledhë gjetjet kryesore nga literatura lidhur me menaxhimin dhe sfidat e kësaj gjendjeje.

Metodologjia: Është kryer një rishikim i literaturës në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar. Janë analizuar artikuj të përzgjedhur që trajtojnë aspektet diagnostike, terapeutike dhe sfidat klinike.

Rezultatet: Literatura thekson se shkaqet më të shpeshta janë reaksionet alergjike ndaj barnave, ushqimeve dhe pickimeve të insekteve, por gjithashtu edhe angioedema e lidhur me përdorimin e inhibitorëve ACE. Diagnostikimi i hershëm bazohet në anamnezë të kujdesshme dhe identifikimin e shenjave si: disnea, stridori dhe disfagia. Trajtimi fillestar standard përfshin administrimin e adrenalinës intramuskulare, kortikosteroideve dhe antihistaminikëve, ndërsa në rastet e përparuara kërkohet sigurimi invaziv i rrugëve të frymëmarrjes me intubim ose trakeostomi. Studimet raportojnë se vonesat në ndërhyrje lidhen me rritje të komplikimeve respiratore dhe mortalitetit. Sfidat klinike përfshijnë vështirësinë e intubimit për shkak të edemit të indeve dhe nevojën për të dalluar edemin alergjike laringeale nga angioedemi jo-alergjike, të cilat nuk i përgjigjen terapive standarde.

Përfundimi: Edemi alergjike e laringut mbetet një emergjencë e rrezikshme për jetën. Evidenca shkencore sugjeron se edukimi i stafit, ndërhyrja e shpejtë dhe bashkëpunimi ndërdisiplinor janë elementët kyç për reduktimin e mortalitetit dhe përmirësimin e rezultateve klinike.

31. Arresti kardiak: Rëndësia e kohës së ndërhyrjes dhe faktorëve prognostik në ambient spitalor dhe jashtëspitalor

Festona Qamili¹, Rinor Canaj², Begush Canaj³

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Spitali Regjional i Gjilanit - Emergjenca

Abstrakti:

Hyrje: Arresti kardiak është humbja e menjëhershme e funksionit të zemrës tek një person që mund të ketë ose jo sëmundje të zemrës. Mund të ndodhë papritur ose pas simptomave të tjera. Shpesh është fatal nëse nuk merren menjëherë hapa të duhur. Arresti kardiak kategorizohet në dy grupe të ndara në varësi të vendndodhjes së arrestit: arrest kardiak në spital (IHCA) dhe arrest kardiak jashtë spitalit (OHCA). IHCA zakonisht ka qasje më të shpejtë në shërbimet mjekësore emergjente dhe kujdes të avancuar krahasuar me OHCA-në. Në përgjithësi, shkallët e mbijetesës janë më të larta për IHCA-në për shkak të ndërhyrjes së menjëhershme mjekësore.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të vlerësohet rëndësia e kohës së ndërhyrjes dhe faktorët prognostik tek pacientët me arrest kardiak, duke analizuar tre raste të paraqitura në ambient spitalor dhe jashtëspitalor.

Metodologjia: Ky punim është realizuar si studim deskriptiv i tipit seri rastesh (Case Series), ku janë përfshirë tre raste, pacientë me arrest kardiak, dy prej tyre që sillen nga jashtë spitalit dhe një që ndodh brenda ambientit spitalor. Të dhënat janë marrë nga protokollet e Emergjencës në SRGj - Gjilan, përfshirë dokumentacionin, historinë klinike, ekzaminimet e kryera, si dhe ecurinë e ndërhyrjes. Për secilin rast është bërë përshkrim i detajuar dhe janë theksuar momentet kyçe që lidhen me kohën e ndërhyrjes dhe faktorët prognostik.

Rezultatet: Nga këto tre raste shohim se rasti 1 dhe 2 (janë raste të sjella prej jashtë spitalit) pacientët janë sjellë në spital në gjendje të rëndë, tashmë në arrest kardiak. Kishte kaluar kohë nga momenti i humbjes së parametrave vital deri tek fillimi i reanimimit të organizuar në spital. Përafërsisht 30-40 min. Kjo kohë është faktor prognostik negativ, sepse truri dhe zemra pësojnë dëmtime të rënda nga mungesa e oksigjenit. Rasti 3 (brenda spitalit) pacienti kishte rënë në arrest gjatë ekzaminimit, pra në prani të stafit. Këtu reanimimi kishte filluar menjëherë, pa vonesë, dhe kthimi në qarkullim spontan ishte më i shpejtë, brenda 10 minutave.

Përfundimi: Koha për ndërhyrje është faktori kyç prognostik që ndan arrestin brenda dhe jashtë spitalit. OHCA ka mortalitet dhe morbiditet më të lartë për shkak të vonesës së fillimit të reanimimit kardiopulmonar, ndërsa IHCA ndodh në prani të stafit të kualifikuar dhe ka prognozë më të mirë, pasi masat e reanimimit sipas ACLS aplikohen menjëherë.

Fjalët kyçe: Arrest kardiorespirator, OHCA, IHCA, koha e ndërhyrjes, reanimimi.

32. Zbatimi i Diagnostikës së Shpejtë Molekulare për të Luftuar Organizmat Rezistentë ndaj Shumë Barnave në Njësitë e Kujdesit Intensiv

Fjorda Berisha, Besë Zogu

Abstrakti:

Sfondi: Shfaqja dhe përhapja e organizmave rezistentë ndaj shumë barnave (MDRO) në njësitë e kujdesit intensiv (ICU) përfaqëson një sfidë kritike për sigurinë e pacientit, rezultatet klinike dhe sistemet e kujdesit shëndetësor në nivel global. Metodat konvencionale mikrobiologjike shpesh përfshijnë kohë të zgjatura të përpunimit, duke vonuar terapinë antimikrobiale të synuar dhe duke kompromentuar përpjekjet e kontrollit të infeksioneve.

Objektivi: Ky studim synon të vlerësojë në mënyrë kritike rolin dhe ndikimin klinik të zbatimit të teknikave të shpejta diagnostikuese molekulare në zbulimin, menaxhimin dhe përmbajtjen në kohë të MDRO-ve brenda njërive të kujdesit intensiv.

Metodat: Është bërë një rishikim gjithëpërfshirës narrativ, duke analizuar literaturën e rishikuar nga kolegët, udhëzimet klinike ndërkombëtare dhe studimet klinike të fundit që përqendrohen në modalitetet diagnostike molekulare siç është reaksioni zinxhir i polimerazës (PCR), analizat multipleks PCR dhe testet e tjera të amplifikimit të acidit nukleik (NAAT). Theksi u vu në saktësinë diagnostikuese, kohën e përpunimit, ndikimin në vendimmarrjen klinike dhe rezultatet që lidhen me programet e kujdesit antimikrobik në pacientët e kujdesit intensiv.

Rezultatet: Diagnostika e shpejtë molekulare e zvogëlon ndjeshëm kohën për të identifikuar MDRO-të krahasuar me teknikat

konvencionale të bazuara në kulturë, duke mundësuar fillimin më të hershëm të regjimeve të përshtatshme antimikrobale. Zbatimi i këtyre metodave korrelon me prognozë të përmirësuar të pacientit, kohëzgjatje të zvogëluar të qëndrimit në kujdesin intensiv dhe ulje të përdorimit të papërshtatshëm ose të spektrit të gjerë të antimikrobikëve. Për më tepër, këto teknologji përmirësojnë protokollet e kontrollit të infeksionit duke lehtësuar zbulimin dhe përmbajtjen e shpejtë të shpërthimit. Pengesat për miratim të gjerë përfshijnë koston, kërkesat e ekspertizës teknike dhe integrimin në rrjedhat ekzistuese klinike të punës.

Përfundim: Integrimi i mjeteve të shpejta diagnostikuese molekulare brenda mjediseve të kujdesit intensiv përbën një qasje transformuese për luftimin e MDRO-ve. Këto teknologji jo vetëm që optimizojnë terapinë antimikrobale, por gjithashtu përforcojnë strategjitë e parandalimit të infeksionit, duke kontribuar në fund të fundit në përmirësimin e rezultateve të pacientëve dhe shfrytëzimin e burimeve të kujdesit shëndetësor. Hulumtimi dhe investimet e vazhdueshme janë thelbësore për të adresuar sfidat e zbatimit dhe për të promovuar aplikim më të gjerë klinik.

33. Diagnostika laboratorike e infeksionit me Hantan Virus në Kosovë

Dr. Gentrit Uka¹, Prof. Ass. Dr. Xhevat Jakupi²

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Abstrakti:

Hyrja: Hanta viruset transmetohen nga brejtësit, dhe infeksioni te njerëzit ndodh përmes thithjes së aerozoleve nga jashtëqitjet dhe urina e tyre. Manifestimet klinike përfshijnë: Sindromën pulmonare dhe Ethet hemorragjike. Diagnostikimi bazohet kryesisht në zbulimin e ARN-së ose antigjeneve të virusit përmes metodave serologjike dhe molekulare.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë metodat diagnostikuese të infeksionit me Hantan virus në Kosovë, bazuar në të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjatë viteve 2022-2024.

Metodologjia: U analizuan të dhënat laboratorike të testimeve me PCR dhe metoda serologjike (ELISA). Në vitin 2022, nga 10 testime me PCR, të gjitha rezultuan negative, ndërsa nga 25 testime serologjike, 4% ishin pozitive. Në vitin 2023, nga 27 testime me PCR, 7% ishin pozitive, ndërsa nga 93 testime serologjike, 4% ishin pozitive. Në vitin 2024, nga 18 testime me PCR, 6% ishin pozitive, ndërsa nga 85 testime serologjike, 5% rezultuan pozitive.

Rezultatet: Diagnostikimi kryesor në Kosovë bazohet në metodat serologjike (ELISA) dhe molekulare (RT-PCR). Numri i rasteve të konfirmuara mbetet i ulët, me rajonet më të prekura Deçanin dhe Junikun.

Përfundimi: Hanta viruset mbeten një kërcënim potencial, dhe diagnostikimi i hershëm me RT-PCR dhe ELISA është thelbësor për menaxhimin e rasteve. Izolimi viral kërkon biosiguri të lartë (BSL-3/4).

34. Roli imunomodulues i vaksinimit kundër SARS-CoV2 në reduktimin e inflamacionit te pacientët e infektuar

Greta Begolli-Stavileci¹, Violeta Lokaj-Berisha², Luljeta Begolli³, Gramos Begolli⁴

^{1,2} Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë

³ Laboratori Bioticus, Prishtinë, Kosovë

⁴ Klinika e Biokimisë Mjekësore, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë.

Abstrakti:

Hyrje: COVID-19 karakterizohet nga një përgjigje imunitare e çrregulluar dhe rritje e markerëve inflamatorë, të cilët lidhen drejtpërdrejt me ashpërsinë klinike të sëmundjes. Vaksinimi kundër SARS-CoV-2 ka treguar efekt imunomodulues duke përforcuar imunitetin adaptiv, ulur nivelin e IL-6 dhe CRP, përmirësuar enzimën hepatike (AST, ALT) dhe raportin neutrofile/limfocite, duke reduktuar inflamacionin sistematik.

Materiale dhe metoda: Studimi përfshiu 50 pacientë të infektuar me SARS-CoV-2, të ndarë në dy grupe: të vaksinuar (n=25) dhe të pavaksinuar (n=25). U matën nivelet e CRP, IL-6, AST, ALT dhe raporti leukocite/neutrofile. U përfshinë pacientë mbi 18 vjeç, ndërsa u përjashtuan gratë shtatzëna/gjdhënëse, individët me malignitete dhe ata nën terapi immunosupresive. U përdorën metoda deskriptive dhe t-test për mostra të pavarura me prag signifikance $p < 0.05$.

Rezultatet: Të vaksinuarit shfaqën vlera dukshëm më të ulëta të IL-6 (13.14 vs. 29.69 pg/mL, $p=0.0010$), CRP (50.78 vs. 133.98 mg/L, $p<0.0001$) dhe raportit LEU/NEUT (0.0824 vs. 0.1447, $p=0.00013$). AST dhe ALT ishin gjithashtu më të ulëta, por pa rëndësi statistikore. U evidentua korrelacion i fortë për IL-6 ($r\approx 0.67$), CRP ($r\approx 0.87$), ALT ($r\approx 0.63$) dhe LEU/NEUT ($r\approx 0.63$); ndërsa për AST korrelacioni ishte mesatar ($r\approx 0.50$).

Parametrat laboratorik	Të vaksinuar	Të pavaksinuar	p
	Mean $\pm$ SD	Mean $\pm$ SD	
CRP	50.78 $\pm$ 22.56	133.98 $\pm$ 23.88	<0.0001
IL – 6	13.14 $\pm$ 6.99	29.69 $\pm$ 11.08	0.0010
AST	53.73 $\pm$ 16.53	102.03 $\pm$ 57.01	0.147
ALT	39.48 $\pm$ 8.78	69.66 $\pm$ 25.15	0.476
LEU/NEUT rat	0.0824 $\pm$ 0.0044	0.1447 $\pm$ 0.0196	0.00013

Përfundim:

Vaksinimi kundër COVID-19 ndërlidhet me ulje të dukshme të IL-6, CRP dhe raportit LEU/NEUT, duke dëshmuar efektin imunomodulues dhe uljen e inflamacionit sistematik.

35. Kujdesi ndaj traumave në fatkeqësi dhe katastrofa

Dr. Isuf Bajrami

Qendra e Mjekësisë Urgjente - Prishtinë

Alma Mater Europea Campus College “Rezonanca”

Abstrakti:

Hyrje: Fatkeqësitë në aspektin global ndodhin për shkaqe natyrore, teknologjike dhe konflikteve njerëzore. Asnjë komunitet nuk është imun:

Edhe spitalet më të sofistikuar mund të bëhen objekte të vështira pas një fatkeqësie, me burime të kufizuara në dispozicion për të siguruar kujdes ndaj viktimave dërmuese.

Skena e katastrofës mund të jetë e rrezikshme, me rreziqe që përfshijnë kolapsin strukturor, shërbimet e ekspozuara dhe përmbytjen.

Menaxhimi efektiv i fatkeqësive nuk është biznes si zakonisht; kjo kërkon një mendim të ndryshëm që njihë nevojën për menaxhimin e popullatës së viktimizuar dhe sigurinë eksplicite të punonjësve të kujdesit shëndetësor.

"Përshtat dhe tejkallo" është slogani i modelit për gatishmërinë.

Kujdesi ndaj viktimave: Një rast i fatkeqësisë masive ekziston kur viktimat tejkalojnë burimet për të siguruar kujdes të plotë individual, zakonisht në një situatë të informatave të paplota dhe pasigurisë në lidhje me evoluimin e ngjarjeve.

Në katastrofë, paradigma e kujdesit ndryshon nga e mira më e madhe për individin në të mirën më të madhe për numrin më të madh të viktimave.

Kjo është ndryshe nga kujdesi traumatik të përditshëm, në të cilin të gjitha burimet mobilizohen për të mirën e një pacienti të plagosur individual.

Mjetet për kujdesin në fatkeqësi masive: Komandat e incidentit dhe triazhës janë mjete thelbësore për kujdesin efektiv të viktimave në masë.

Komanda e incidentit është një mjet i menaxhimit të sistemit që transformon organizatat ekzistuese përmes planifikimit, operacioneve, logjistikës dhe funksioneve financiare/administrative për përgjigje të integruar dhe të koordinuar.

Vendimet e triazhës diferencojnë viktimat në një shkallë më të lartë, pasi viktima largohet nga skena në mjedise të tjera dhe në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Katër kategoritë e triazhës janë:

1. ImEDIATE (e **KUQE**): Lëndime të menjëhershme jetëkërcënuese.
2. Të vonshme (e **VERDHË**): Lëndime që kërkojnë trajtim brenda 2 orëve.
3. Minimale (e **GJELBËR**): I lënduar që ecë dhe psikiatrik.
4. I Vdekur (e **ZEZË**);

Çdo kategori e viktimave duhet të ketë një zonë të përcaktuar për grumbullimin dhe menaxhimin.

Fushata e stop gjakderdhjes: Kontrolli i gjakderdhjes për të lënduarit (B-Con), i shkurtër kurs modular i zhvilluar nga Shoqata Kombëtare e Infermierëve të urgjencës mjekësore dhe të bashkë-sponsorizuar nga Komiteti i Kolegjit Amerikan të Kirurgëve për Trauma në mbështetje të fushatës kombëtare "Stop the Bleed" (Stop gjakderdhjes). Është projektuar për të udhëzuar personin jo profesionist.

Ky modul prezanton konceptet e presionit të jashtëm, turniket, veshjet hemostatike, dhe manovrat bazë të rrugëve të frymëmarrjes. Fjalë kyçe: Trauma, fatkeqësi, katastrofa, masive, gjakderdhja.

36. Emergjenca mjekësore të infeksioni me hantavirus

L. Ajazaj Berisha¹, S. Ahmeti², B. Halili¹, B. Haraqia¹, A. Aliu Bejta¹, V. Krasniqi¹, A. Vishaj¹, S. Hyseni¹, L. Tafilaj¹, N. Hasani¹, H. Gashi¹, G. Morina¹, A. Bytyqi¹, A. Jaka¹, D. Elezaj¹, B. Thaqi¹, A. Berisha¹, Y. Berisha¹, Jon Hoti², Tea Guguli³.

¹ Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Infektive, Prishtinë.

² Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë.

³ University of Debrecen, Faculty of Medicine, Hungary.

Abstrakti:

Hantavirusi është një virus me patogjenitet të lartë që shkakton forma të rënda të etheve hemorragjike me sindromë renale (EHSR). Për shkak të manifestimeve multiorganike dhe nevojës për trajtim intensiv, EHSR konsiderohet një emergjencë mjekësore. Në këtë studim janë paraqitur sfidat klinike, komplikimet e sëmundjes dhe rezultatet e trajtimit të pacientëve me EHSR të mjekuar në Klinikën Infektive gjatë periudhës 2014-2023. Në analizën retrospektive u përfshinë 39 raste të konfirmuara me hantavirus, 30 meshkuj dhe 9 femra, me moshë mesatare 37.8 vjeç. Koha mesatare e qëndrimit në spital ishte 21.6 ditë. Mortaliteti u shënuar në 4 raste (10.2%), me moshë mesatare 35 vjeç. Ndërlikimi më i rëndë ishte sindroma e distresit akut respirator (ARDS), e shfaqur në 4 pacientë; prej

tyre 3 përfunduan me vdekje dhe një u shërua. Ventilimi mekanik u realizua në 3 raste me ARDS prej të cilëve dy përfunduan me vdekje, ndërsa një mbijetoi. Hemodializa (HD) u realizua në 69.2% të pacientëve, nga të cilët 23 u shëruan dhe 4 përfunduan me vdekje. Të dhënat tona theksojnë rëndësinë e monitorimit intensiv dhe të ndërhyrjes së hershme, veçanërisht në rastet me komplikime pulmonare dhe insuficiencë akute renale. Komplikimet respiratore dhe renale janë faktorët kryesor që e bëjnë EHSR një emergjencë mjekësore. Identifikimi i hershëm i rasteve dhe ndërhyrja e shpejtë terapeutike janë faktorë kyç për ecurinë e mirë të sëmundjes dhe mbijetesën e pacientëve.

Fjalët kyçe: Hantavirusi, ethet hemorragjike me sindromë renale, emergjenca mjekësore.

37. Rëndësia e analizave laboratorike në menaxhimin e pacientëve në kujdesin intensiv

Dr. Mimoza Hasimja-Syla

Dr. Majlinda Miftari

Dr. Dashurije Gashi - Zymberi

¹ Qendra Klinike Universitare, Prishtinë

² Departamenti i Biokimisë Mjekësore

Abstrakti:

Hyrje dhe qëllimi: Analizat laboratorike përbëjnë një shtyllë themelore në menaxhimin e pacientëve në gjendje kritike në Njësitë e Kujdesit Intensiv (MIQ). Këta pacientë shfaqin ndryshime të shpejta fiziologjike, dhe monitorimi i vazhdueshëm përmes testeve laboratorike është esencial për diagnostikim të saktë, vlerësimin e ecurisë së sëmundjes dhe përshtatjen e strategjive terapeutike. Qëllimi i këtij punimi është të theksojë rolin jetik të analizave laboratorike në vendimmarrjen klinike dhe përmirësimin e rezultateve të pacientit në kujdesin intensiv.

Metodologjia: Ky punim shqyrton përdorimin rutinë dhe të specializuar të një game të gjerë të analizave biokimike dhe hematologjike. Të dhënat objektive merren nga monitorimi serik i parametrave kyç, duke përfshirë gazometrinë arteriale, elektrolitet, funksionin renal dhe hepatic, hemogramin e plotë, testet e koagulimit dhe markerët e inflamacionit si Proteina C-Reaktive (CRP) dhe prokalcitonina. Këto analiza kryhen në intervale të rregullta kohore, të përcaktuara nga gjendja klinike dinamike e pacientit.

Rezultatet: Të dhënat laboratorike ofrojnë pasqyrë të menjëhershme mbi statusin hemodinamik, metabolik dhe inflamator të pacientit. Rezultatet e analizave mundësojnë identifikimin e hershëm të disfunksionit të organeve, siç është dëmtimi akut i veshkave ose insuficienca hepatis. Për shembull, nivelet e larta të laktatit shërbejnë si një tregues i hipoperfuzionit indor, ndërsa monitorimi i gazometrisë arteriale është thelbësor për menaxhimin e pacientëve në ventilim mekanik.

Konkluzionet: Analizat laboratorike janë një mjet i pazëvendësueshëm në menaxhimin modern të pacientëve në kujdesin intensiv. Ato sigurojnë të dhëna objektive dhe të matshme që janë thelbësore për diagnostikimin e gjendjeve kritike, monitorimin e përgjigjes ndaj trajtimit dhe parashikimin e prognozës. Integrimi i saktë dhe i shpejtë i rezultateve laboratorike në praktikën klinike përmirëson ndjeshëm cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe kontribuon në uljen e morbiditetit dhe mortalitetit të kësaj kategori të pacientëve.

38. Inteligjenca artificiale në diagnostikimin imazherik të embolisë pulmonare - Një rishikim

Asst. Dr. Mrikë Bunjaku¹ PhD , Prof. Asst. Dr. Kreshnike Dedushi-Hoti², Prof. Asst. Dr. Ilaz Bunjaku², Prof. Dr. Serbeze Kabashi-Muçaj³, Prof. Asst. Dr. Eqrem Gara^{2,3}, Dr. Vera Berisha-Ndrejaj-MSc^{2,3}, Prof. Dr. Sadije Namani^{2,3}, Dr. Arjeta Zogaj-Berisha - MD^{2,3}, Asst. Dr. Gramoz Bunjaku-PhDC^{2,3}

¹ Fakulteti i Mjekësisë-UPHP, Prishtinë, Kosovë

² Fakulteti i Mjekësisë-UPHP-QKUK-Klinika e Radiologjisë, Prishtinë, Kosovë

² Imperium Medical Clinic , Prishtinë, Kosovë

^{2,3} Imperium Medical Clinic , Prishtinë, Kosovë

^{2,3} Fakulteti i Mjekësisë-UPHP-QKUK-Klinika e Sëmundjeve Infektive, Prishtinë, Kosovë

^{2,3} Fakulteti i Mjekësisë-UPHP, Prishtinë, Kosovë

Abstrakti:

Hyrje: Embolia pulmonare (EP) është një gjendje serioze dhe kërcënuese për jetën, e karakterizuar nga bllokimi i arterieve pulmonare me trombë. Diagnostikimi i shpejtë dhe i saktë është kritik për reduktimin e morbiditetit dhe mortalitetit. CT-angiografia pulmonare (CTPA) mbetet metoda e artë diagnostike, por ngarkesa e madhe e punës dhe variabiliteti ndër-observator paraqesin sfida klinike.

Qëllimi: Qëllimi i punimit është të shqyrtojë rolin e inteligjencës artificiale (IA) në diagnostikimin e embolisë pulmonare, duke krahasuar performancën e saj me interpretimin tradicional të radiologëve dhe duke diskutuar potencialin për integrim në praktikën klinike.

Metodologjia: Ky rishikim narrativ bazohet në literaturë të publikuar gjatë periudhës 2007-2025, duke përdorur data baza kryesore si: PubMed, Scopus, Web of Science dhe Embase. U përfshinë studime origjinale dhe rishikime që raportojnë performancën diagnostike të IA në CTPA për EP, duke përfshirë ndjeshmëri, specifike, AUC dhe krahasime me radiologët.

Rezultatet: IA e aplikuar në CTPA ka treguar ndjeshmëri 0.85-0.93 dhe specificitet 0.95-0.99, duke demonstruar performancë të krahasueshme me radiologët e trajnuar. Një përfitim i rëndësishëm është reduktimi i “miss rate” për EP-të incidentale. Integrimi i algoritmeve në sistemet PACS/RIS mundëson prioritizimin automatik të skanimeve dhe përshpejtimin e rrjedhave të punës klinike. Modelet e bazuara në mësimin e thellë ofrojnë gjithashtu triazhim automatik, funksion “second-read” si mbështetje diagnostike, si dhe kuantifikim të ngarkesës trombotike. Megjithatë, përdorimi në praktikën e përditshme kërkon validim multicenter dhe një bashkëpunim të ngushtë me ekspertizën klinike të radiologëve.

Përfundimi: Inteligjenca artificiale është një mjet i vlefshëm për diagnostikimin e EP në CTPA, duke përmirësuar saktësinë diagnostike, efikasitetin klinik dhe vendimarrjen terapeutike. Integrimi i IA në praktikën klinike mund të përforcojë kapacitetet diagnostike, duke kontribuar në kujdes më të shpejtë dhe më të sigurt për pacientët me emboli pulmonare.

Fjalët kyçe: *Embolia pulmonare, CT- angiografia pulmonare, Inteligjenca artificiale.*

39. Prezantim rasti - Pacienti me politraumë të rëndë dhe hemopneumotoraks

Musli Gashi^{1,2}, Sinan Musliu², Avdush Bajgora², Adem Jaha², Bekim Grapci², Driton Zyba²

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës” Hasan Prishtina”

² Klinika Emergjente, Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Abstrakti:

Hyrje: Politrauma është lëndimi i shumë sistemeve të organeve në të njëjtën kohë. Konsiderohet si një ndër problemet më aktuale, kozmopolite dhe me rëndësi të jashtëzakonshme për shoqërinë bashkëkohore. Diagnoza dhe trajtimi i hershëm me një qasje të shpejtë dhe multidisciplinore janë kritike në politraumë sepse ato rrisin shkallën e mbijetesës dhe ulin rrezikun e vdekjeve të panevojshme duke njohur dhe adresuar menjëherë lëndimet kërcënuese për jetën.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të prezantohet një rast me politraumë të rëndë me kontuzion masiv pulmonar dhe hemorragji intrapulmonare.

Prezantimi i rastit: Një mashkull shqiptar i moshës 27 vjeçare, i cili ka rënë nga lartësia prej 8 m nga një objekt ndërtimi ka ardhur në Qendrës Emergjente me autoambulancë i intubuar por pa shenja jete; pa tension arterial, pa puls pa frymëmarrje spontane. Nga ekipi emergjent bëhen përpjekje për reanimim, i jepet adrenalinë, dopaminë, dy doza gjak 0 negativ. Menjëherë thirren për konsultime: kirurgu torakal, urologu, kirurgu abdominal dhe kardiologu. I bëhet Echo e toraksit dhe abdomenit ku konstatohet kontuzion masiv i mushkërive, hemopneumotoraks i anës së majtë dhe prezencë e gjakut në tubusin endotraheal. Pacienti ka pasur edhe frakturë të hapur të femurit. Analizat biokimike kryesore Hgb 10.1, Hct 24.3, RBC 3.52. Nga kirurgu torakal menjëherë bëhet torakotomia emergjente e anës së majtë dhe evakuohet likuidi prej 700 ml. Kardiologu konstaton se nuk ka dritare ekokardiogra fike për të përcaktuar/përgjashtuar tamponadën e zemrës.

Përfundimi: Përkundër përpjekjeve multidisciplinore pacienti nuk mund të kthehet në jetë.

Fjalët kyçe: Politrauma, hemopneumothoraksi, prezantim rasti.

40. Vlerësimi i efektit të kombinuar të Citomegalovirusit kongjenital dhe virusit Epstein-Barr në zhvillimin e autizmit

Dr. Njomza Uka

Kolegji Heimerer

Abstrakti:

Hyrje: Infeksionet virale gjatë shtatzënisë, veçanërisht ato me Citomegalovirus (CMV) dhe Epstein-Barr Virus (EBV), janë propozuar si faktorë të mundshëm për zhvillimin e çrregullimeve neurozhvillimore, përfshirë autizmin. Ky studim vlerëson ndikimin e tyre individual dhe të kombinuar në shfaqjen e ASD-së te fëmijët në Kosovë.

Objektiva/Qëllimi: Të vlerësohet lidhja ndërmjet infeksioneve kongjenitale me CMV dhe EBV dhe shfaqjes së ASD-së, veçmas dhe në kombinim.

Materiale & Metoda : Studimi përfshiu 54 fëmijë të moshës 2-12 vjeç (12 me ASD dhe 42 në grupin kontroll). U përdorën pyetësorë demografik, intervista me prindërit, dokumentacioni mjekësor dhe vlerësimi CARS. Analiza statistikore u realizua me SPSS, përmes T-testit dhe analizës së korrelacionit.

Rezultatet & Diskutime: U konstatua një lidhje statistikisht e rëndësishme midis ekspozimit ndaj CMV dhe shfaqjes së simptomave të ASD-së. Fëmijët e ekspozuar ndaj të dy viruseve (CMV + EBV) shfaqën simptoma më të theksuara krahasuar me grupet e tjera. Ekspozimi ndaj vetëm EBV nuk lidhej me rrezik të shtuar, por bashkëveprimi i dyfishtë sugjeron efekt sinergjik.

Konkluzionet: Infeksionet kongjenitale me CMV, sidomos kur bashkëekzistojnë me EBV, mund të përbëjnë faktorë të rëndësishëm rreziku për ASD.

Rekomandime: Rekomandohet skринing rutinë për infeksione virale gjatë shtatzënisë dhe monitorim i hershëm i fëmijëve të ekspozuar. Nevojiten studime të mëtejme me mostra më të mëdha për konfirmim.

41. Ketofoli në sedacionin procedural në urgjencë: Optimizimi i sigurisë, stabilitetit hemodinamik dhe rikuperimit në rastet urgjente

Dr. Lis Kusari¹, Dr. Pranvera Beqiraj².

¹ Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë.

² Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë

Abstrakti:

Hyrje: Në mjediset e urgjencës, procedurat invazive shpesh kërkojnë sedacion të shpejtë dhe të besueshëm, që ofron qetësim të mjaftueshëm pa komprometuar funksionet vitale. Kombinimi i ketaminës dhe propofolit, i njohur si ketofol, është vlerësuar si një opsion i qëndrueshëm për sedacionin procedural. Ky kombinim siguron një ekuilibër ndërmjet stabilitetit hemodinamik dhe thellësisë së sedacionit, duke shfrytëzuar vetitë plotësuese të secilit medikament. Përdorimi i përbashkët synon të rrisë sigurinë dhe të përshpejtojë rikuperimin e pacientëve gjatë procedurave të shkurtra por të dhimbshme.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë evidencën e disponueshme mbi përdorimin e ketofolit në urgjencë. Gjithashtu synon të analizojë ndikimin e tij në sigurinë klinike dhe stabilitetin hemodinamik, si dhe të vlerësojë përfitimet në kohën e rikuperimit dhe incidencën e efekteve anësore, krahasuar me përdorimin e propofolit ose ketaminës veçmas.

Metodat: U krye një rishikim i literaturës në baza të ndërkombëtare (PubMed, Scopus, Google Scholar), duke përfshirë studimet e publikuara gjatë dekadës së fundit (2015-2025). U përzgjedhën artikuj që trajtonin përdorimin e ketofolit për sedacion procedural te pacientët adultë në ambientet e kujdesit urgjent. Janë shqyrtuar parametrat hemodinamik, cilësia e sedacionit dhe kohëzgjatja e rikuperimit.

Rezultatet: Gjetjet tregojnë se ketofoli ofron sedacion efektiv, ruajtje të mirë të parametrave vital dhe rikuperim të shpejtë. Në veçanti, është dokumentuar përdorimi i tij në intubim urgjent, reduktim manual të frakturave dhe luksacioneve, vendosje të tubit torakal në rastet e pneumotoraksit, largimi i trupave të huaj dhe procedura të dhimbshme gastrointestinale apo urologjike si lavazhi gastrik dhe kateterizimi traumatik.

Përfundimi: Bazuar në evidencën e rishikuar, ketofoli paraqet një alternativë të sigurt dhe të balancuar për sedacionin procedural në urgjencë. Përdorimi i tij mund të kontribuojë në rritjen e sigurisë klinike dhe përmirësimin e përvojës së pacientit. Rekomandohet shqyrtim i mëtejshëm në kontekste të ndryshme klinike dhe trajnime praktike për integrim në protokollet ekzistuese të sedacionit.

Fjalët kyçe: Ketofol, sedacion procedural, urgjencë, propofol, ketaminë, stabilitet hemodinamik, rikuperim klinik.

42. Sepsa meningokoksike si sëmundje emergjente në Kosovë

Sadije Namani, Gramoz Bunjaku, Vera Ndrejaj Berisha, Albina Ponosheci Biçaku, Gëzim Morina, Luljeta Tërstena Hasani.

Klinika Infektive, Prishtinë, QKUK

Abstrakti:

Hyrja dhe qëllimi: Sepsa meningokoksike vazhdon të jetë sëmundje emergjente me shkallë të lartë të vdekshmërisë. Qëllimi i këtij studimi ishte të analizojmë prezantimin klinik dhe ecurinë e sepsës meningokoksike te fëmijët në Kosovë gjatë një dekade.

Materiale dhe metodat: Punimi paraqet një studim prospektiv dhe retrospektiv të fëmijëve të trajtuar me sepsë meningokoksike gjatë viteve 2009 - 2018, në Klinikën Infektive, QKUK.

Rezultatet: Nga 40 fëmijë të trajtuar me sëmundje invazive meningokoksike, 19 raste (47.5%) manifestuan sepsën meningokoksike (SM) dhe 21 raste (52.5%) manifestuan sepsën meningokoksike me meningjit (SMM). Shumica e fëmijëve, 32 (80%) manifestuan simptomat brenda 24 orëve, 6 fëmijë me SM (15%) manifestuan simptomat <12 orë, ndërsa kohëzgjatjen e simptomave >24 orë kishin vetëm dy raste me SMM (5%). Moshë mesatare e pacientëve ishte e ngjashme në të dy grupet [SM = 3.0 vjeç (9 muaj - 16 vjeç)] dhe SMM = 3.2 vjeç (9 muaj - 14 vjeç)]. Fëmijët u trajtuan më së shpeshti me Penicilinë 67% me SMM dhe 53% me SM dhe Ceftriaxone 33% me SMM dhe 47% me SM. Hemorragjitë masive të lëkurës me nekrozë periferike të gishtërinjve të duarve dhe të këmbëve u manifestuan te katër fëmijë, dy në secilin grup me amputim të pjesëve nekrotike te një fëmijë me SM. Nuk patëm vdekje te fëmijët të cilët manifestuan SMM, ndërsa patëm dy vdekje te fëmijët me SM (M=10.5%).

Përfundimi: Sepsa meningokoksike, e manifestuar pothuajse në gjysmën e pacientëve me sëmundje invazive meningokoksike, vazhdon të jetë një sëmundje emergjente jetëkërcënuese për fëmijët në Kosovë.

43. Emergjenca mjekësore te sëmundjet infektive

Prof. Dr. Salih Ahmeti

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë

Abstrakti:

Emergjencë mjekësore është një gjendje shëndetësore e papritur dhe e rëndë, që paraqet rrezik për jetën ose shëndetin e të sëmurit, dhe që kërkon ndërhyrje të menjëhershme mjekësore. Emergjenca mjekësore infektive shkaktohet nga agjentët biologjik, si bakteret, viruset, protozoarë apo fungje, të cilët futen në organizmin e njeriut me ajër, ujë, ushqime të kontaminuara, kontakt direkt ose indirekt e ndonjëherë përmes insekteve të ndryshme apo kafshimeve nga kafshët. Sipas OBSH-së, rreth një e treta e vdekjeve, në nivel global, shkaktohen nga këto sëmundje. Manifestohen me forma të lehta deri të rënda dhe kërcënuese për jetën e të sëmurit. Manifestimet klinike të larmishme, përkundër arritjeve bashkëkohore laboratorike, e vendosin shpesh mjekun klinik para sfidave të diagnozës së saktë dhe diferencimit diagnostik. Diagnostikimi i shpejtë e në kohën e duhur dhe tretmani terapeutik adekuat është përcaktues për ecurinë e sëmundjes. Sëmundjet infektive paraqesin emergjencë mjekësore jo vetëm për diagnostikim dhe trajtim të shpejtë por edhe për shkak të përhapjes së tyre epidemike apo pandemike. Emergjencë mjekësore më shpesh paraqesin sëmundjet infektive si: sepsa dhe shoku septik, meningjiti bakterial, encefaliti, infeksionet e frymëmarrjes (pneumonia, laringjiti), tetanosi, rabiesi, malaria, kolera, ethe hemorragjike (Ebola, Ethe hemorragjike Congo-Crime, Ethe hemorragjike me sindrom renal, Ethe Lassa, Marburg), hepatiti viral fulminant, format e rënda të Covid 19, fasciti nekrotizues etj.

Kosova është vend endemik për shumë sëmundje infektive, të cilat shfaqen me forma të rënda dhe emergjenca mjekësore, prekin grup-moshë të ndryshme dhe shkaktojnë vdekje të shpeshta.

Fjalët kyçe: Sëmundjet infektive, emergjenca mjekësore, Kosova.

44. Rishikimi i paradigmës së sepsës: Udhëzuesi S3 dhe sfida e zbatimit klinik

Dr. Vera Berisha-Ndrejaj¹, Dr. Gramoz Bunjaku¹, Dr. Arjeta Zogaj-Berisha², Dr. Veli Rexha², Dr. Sadije Namani², Dr. Luljeta Hasani², Dr. Gëzim Morina², Dr. Ilir Tolaj², Dr. Murat Mehmeti²

¹ Fakulteti i Mjekësisë-UPHP, Prishtinë, Kosovë

¹ QKUK-Klinika e Sëmundjeve Infektive, Prishtinë, Kosovë

² QKUK-Klinika e Sëmundjeve Infektive, Prishtinë, Kosovë

Abstrakti:

Hyrje: Sepsa përfaqëson një gjendje kritike dhe një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë në kujdesin intensiv në nivel global. Menaxhimi i saj efektiv kërkon udhëzues klinik të përditësuar, të bazuar në evidencë dhe të aplikueshëm në praktikën klinike të përditshme.

Qëllimi: Ky prezantim synon të ofrojë një përmbledhje të udhëzuesit të ri S3 për sepsën 2025, duke u fokusuar në diagnostikimin, trajtimin, parandalimin dhe përkujdesjen pas akute. Një theks i veçantë i kushtohet mundësive dhe sfidave të zbatimit në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Metodologjia: Udhëzuesi është zhvilluar nga ekspertë multidisiplinarë gjermanë dhe përfshin 88 pyetje PICO, me rekomandime të bazuara në rishikime sistematike të literaturës deri në fund të vitit 2024. Analiza shqyrton përmbajtjen dhe aplikueshmërinë e rekomandimeve në kontekstin lokal.

